

Karakteristikat e veprimtarisë edukative të Shoqërisë së Jezusit

Përktim i **dokumentit të parë zyrtar të pedagogjisë** për shkollat e mesme të drejtuara nga **Etërit Jezuitë**.

Për këtë botim në shqip kanë punuar disa mësues dhe bashkëpunëtorë të **shkollës së mesme “Pjetër Meshkalla”**, Shkodër, që synon të zhvillohet sipas këtij projekti edukativ.

Dokumenti i drejtohet mësuesve dhe personelit jomësior, prindërve dhe nxënësve që të gjithë të japin ndihmesë sa më të mirë në përgatitjen e njerëzve të pjekur, të aftë, të ditur dhe të hapur në solidaritetin për progresin e Shqipërisë së re.

Një falenderim të zjarrtë të gjithëve për bashkëpunimin.

Shkolla e Mesme “Pjetër Meshkalla”
SHKODER

Botimi i parë tetor 1995
Botimi i dytë tetor 1996
Hyrje

(1) Në shtatorin e vitit 1980 u mblodh në Romë një grup i vogël, i përbërë nga jezuitë dhe laikë nga vende të ndryshme të botës, për të diskutuar tematika të ndryshme e të rëndësishme lidhur me edukimin në shkollat e Shoqërisë së Jezusit. Në shumë vende të botës janë bërë pyetje serioze mbi efektshmërinë e sotme të shkollave të jezuitëve: a përbëjnë ato një mjet të përshtatshëm për të arritur qëllimet apostolike të Shoqërisë së Jezusit? Janë ato në gjendje t'u përgjigjen nevojave të njerëzve të shoqërisë së sotme? Takimi qe organizuar për të trajtuar pikërisht këto çështje dhe për të sugjeruar formën e rinovimit që do t'i jepte mundësi edukimit në shkollat e mesme të Shoqërisë të vazhdojë të japë ndihmesën e vet në misionin krijues e shëlbues të kishës, sot dhe në të ardhmen.

(2) Gjatë diskutimeve doli sheshit që efektshmëria përtëritëse e shkollave tona varet, pjesërisht, nga një kuptim më i qartë **i vetë natyrës** së edukimit injacian. Pa mohuar problemet e shumta dhe serioze, që kërkojnë zgjidhje, grupi shprehu mendimin që shkollat e Shoqërisë mund të përballojnë me siguri sfidat e së ardhmes nëse **i qëndrojnë besnike trashëgimisë specifike injaciane**. Vizioni i Shën Injacist nga Loyola, themelues i Shoqërisë së Jezusit, ka gjallëruar këto shkolla për katër shekuj me radhë. Po qe se kjo vizion shpirtëror do të thellohet e do të zbatohet në procesin e edukimit në mënyrë të përshtatshme për kohën tonë, ai mund të përbëjë kontekstin me të cilin mund të përballoheshin edhe problemet e tjera.

(3) Atë Pedro Arrupe, atëherë Epror i Përgjithshëm i Shoqërisë së Jezusit, bëri këtë konkluzion kur në fjalën e tij në përfundim të këtij takimi, u shpreh që një shkollë e Shoqërisë

“duhet të jetë e identifikuar lehtësisht si e tillë. Në shumë drejtime ajo është e njëjtë me shkollat e tjera ... por nëqoftëse kemi të bëjmë me të vërtetë me një shkollë të Shoqërisë – d.m.th., po qe se veprimi të shtyrë nga pozitë që përbëjnë forcën e dhuntisë sonë **duke vënë theksin pikërisht në karakteristikat tona thelbësore** – me opsionet tona, edukimi që nxënësit tanë marrin aty do t'i ngulitë njëfarë 'Injacionidad', po të më lejohet një term i tillë. Nuk kemi të bëjmë me qëndrime snobe apo arrogante, as të shtyrë nga komplekse superioriteti. Është rrjedhojë logjike e faktit që **ne jetojmë dhe punojmë për hir të kësaj dhuntie**. Përgjegjësia jonë është t'i përkushtohemi shërbimit që Hyji dhe kisha kërkojnë nga 'ne'.”⁽¹⁾

(4) Pjesëmarrësit e takimit të Romës kërkuar që të formohet një grup i përhershëm me përbërje ndërkombëtare për të trajtuar çështjet e lidhura me edukimin në shkollat e mesme, duke rekomanduar që qartësimi i mënyrave me të cilin vizioni i Shën Injacist vazhdon të saktësojë vetë karakterin e shkollave të mesme të sotme të jezuitëve, të bëhet njëra nga detyrat kryesore të këtij komisioni.

(5) Përshtat këtij rekomandimi, u krijua Komisioni Ndërkombëtar për Apostullimin e Edukimit të Shoqërisë (CIAE-SI), që bëri takimin e tij të parë më 1982. Qenë thirrë për të bërë pjesë në të Daven Day, S.I. (Australi), Vincent Dominuco, S.I. (U.S.A.), Luiz Fernando Klein, S.I. (Brazil, nga viti 1983, Raimondo Kroth, S.I. (Brazil, deri në vitin 1983), Guillermo Marshall, S.I. (Kili, deri në vitin 1984), Jean-Claude Michel, S.I. (Zaire), Gregory Naik, S.I. (Indi), Vicente Parra, S.I. (Spanjë), Pablo Sada, S.I. (Venezuelë), Alberto Vasquez (Kili, deri në vitin 1984), Gerard Zaat, S.I. (Holandë), dhe James Sauv , S.I. (Rom ).

(6) Dokumenti q  kemi n  dor , i p rpunuar nga Komisioni,  sht  frut i takimeve dhe i konsultimeve kat rvjeqare t  zhvilluara n  gjith  bot n.

(7)  do p rpykje p r t  folur sot p r edukimin e jezuit ve, duhet t  marr  parasysh ndryshimet e thella q  kan  ndikuar n  proceset edukative q  nga koha e Sh n Injacit, por n  veqanti gjat  k tij shekulli. Normat e qeverive, apo ndikimi i organizatave t  tjera t  jashtme ndaj shkollave tona, prekin shum  aspekte t  jet s shkollore, duke mos p rjashtuar programin e studimeve dhe p rdorimin e teksteve m simore. N  disa vende, vija politike e qeverive apo  mimet shum  t  larta p r ndjekjen e shkoll s, rrezikojn  vet  q nien e shkoll s joshtet rore. Student t dhe prind rit jan , n  shum  raste, t  interesuar vet m p r mbar vajtjen n  m sime q  mund t u siguroj  f mij ve t  tyre hyrjen n  universitet, ose vet m p r ato programe q  do t i nevojiten p r t  gjetur pun . Shum  shpesh jezuit t kan  futur n  shkollat e tyre bashkeducimin dhe grat  kan  p rkrah laik t dhe jezuit t si m sues dhe administrator . N  pjes n m  t  madhe t 

shkollave t  Shoq ris   sht  v n  re n j shtim i duksh m n  p rmasa i trup s s  student ve dhe nj koh sisht nj  zvog lim i numrit t  jezuit ve n  mbar shtrimin e shkoll s. P rveq k saj:

- a. Programi i studimeve ka p suar modifikime n  p rshtatje me zhvillimet moderne t  shkenc s dhe t  teknologjis : si rezultat ka patur nj  k rkese m  t  vog l p r kurset shkencore, shoq ruar n  disa raste me nj far  n nvleft simi p r l nd t e karakterit humanitar, tradicionalisht t  theksuara n  shkollat e jezuit ve.
- b. Zhvillimi i psikologjis  dhe i shkencave shoq rore, bashk risht me zhvillimet e teoris  pedagogjike dhe t  vet  veprimtaris  edukative, kan  hedhur drit  t  re n  m nyrat me t  cilat t  rinjt  arrijn  pjekurin  brendap rbrenda bashk sis ; t  gjitha k to kan  ndikuar n  p rmbajtjen e kurseve, teknikave t  m simdh nies dhe n  politik n e p rgjithshme t  shkoll s.
- c. N  vitet e fundit, zhvillimi i teologjis  ka njohur haptazi dhe ka p rkrahur rolin apostolik t  laik ve n  kish ; kjo gj   sht  ratifikuar nga Koncili II i Vatikanit, veqan risht me “Dekretin mbi Apostullimin e Laik ve”.² Duke i b r  jehon  k saj teologjie, Kongregacionet e fundit t  P rgjithshme t  Shoq ris  s  Jezusit kan  ngulur k mb  n  bashk punimin midis jezuit ve dhe laik ve p rmes ndarjes efektive t  objektivave dhe t  p rgjegj sive n  shkollat tona, dikur t  kontrolluara e t  drejtuara vet m nga jezuit t.

d. Shoqëria e Jezusit është angazhuar për një “Shërbim të fesë në të cilin nxitja e drejtësisë përbën kërkesën absolute.”³ Shoqëria ka kërkuar “të rishikojë metodat tona apostolike tradicionale, qëndrimet tona, institucionet tona, me qëllim përshtatjen e kërkesave të reja të epokës sonë dhe, në një plan më të gjerë, të një bote në ndryshim e sipër.”⁴ Për t’iu përgjegjur këtij angazhimi është ndërmarrë një rishikim i kujdesshëm i qëllimeve dhe i mundësive kundrejt nevojave të të varfërve dhe të atyre që jetojnë në situata të pafavorshme. Qëllimi i sotëm i misionit edukativ të jezuitëve është përshkruar me termat e porsaformuara “agjentë shumëfishues” dhe “gra e burra për të tjerët.”⁵

e. Studentët dhe profesorët e shkollave të sotme të jezuitëve vijnë nga një larmi e madhe shtresash të ndryshme shoqërore, kulturore dhe fetare; disa prej tyre janë pa ndonjë bindje të caktuar fetare. Shumë shkolla të Shoqërisë janë prekur thellësisht nga ky kompleksitet i pasur dhe i vështirë i bashkësive të tyre edukative.

(8) Këto dhe shumë faktorë të tjerë kanë ndikuar në zhvillimin konkret të jetës shkollore dhe kanë modifikuar disa orientime bazë të shkollave. Por kjo nuk ndryshon bindjen që **edhe sot i njëjti shpirt gjallëron çdo shkollë, që pretendon të quhet dhe të jetë me të vërtetë e Shoqërisë. Ky shpirt mund të zbulohet përmes reflektimit mbi përvojën e jetuar nga Shën Injaci, mbi mënyrën me të cilën kjo përvojë u nda me të tjerët, mbi mënyrën me të cilën vetë Shën Injaci ka zbatuar vizionin e tij edukativ në Kushtetutat dhe në letrat e tij, dhe së fundi, mbi mënyrën me të cilën ky**

vizion është zhvilluar e zbatuar në procesin edukativ gjatë rrjedhës së historisë deri në ditët tona. Shpirti i përbashkët ndodhet në bazën e pedagogjisë, të programeve mësimore dhe të jetës në shkollë, edhe nëse ato mund të jenë shumë të ndryshme nga shekujt e kaluar, edhe nëse hollësitë konkrete përbërëse të jetës shkollore mund të ndryshojnë thellësisht nga një vend në tjetrin.

(9) Termi “specifik” nuk duhet të merret në kuptimin “i vetëm”, si përse u përket metodave, ashtu dhe frymëzimeve të tyre. Qëllimi ynë është kryesisht të përshkruajmë “mënyrën tonë të procedimit”:⁶ frymëzimin origjinal, vlerat, qëndrimet dhe stilin që kanë karakterizuar tradicionalisht edukimin e jezuitëve, që edhe sot duhet të jetë karakteristikë për një shkollë të vërtetë të Shoqërisë, kudo që të veprojë ajo, dhe që në thelb do të mbesë si bazë e ecjes sonë drejt të ardhmes.

(10) Të flasësh për një frymëzim që gjallëron shkollat e jezuitëve nga ana e Shoqërisë së Jezusit nuk nënkupton përjashtimin e atyre që nuk janë pjesëtarë të kësaj Shoqërie. Pavarësisht se **shkolla** quhet në fakt “e jezuitëve”, **vizioni** që e gjallëron atë e bën më të përshtatshëm përcaktimin e saj si “injaciane”, dhe në fakt ajo nuk ka qenë kurrë e kufizuar vetëm tek jezuitët. Shën Injaci ishte një laik kur bëri përvojën e thirrjes së Hyjit që më pas e përshkroi në “Ushtrimet Shpirtërore”, si dhe kur udhëhoqi laikët e tjerë me anë të së njëjtës përvojë. Në katër shekujt e fundit, një numër i madh laikësh dhe pjesëtarësh të kongregacioneve të tjera fetare kanë bërë të vetën përvojën e Shën Injacit duke qenë nën influencën e frymëzimit të tij. Gjithashtu laikët duhet të sjellin me

vete ndihmesën e tyre specifike, të mbështetur në përvojën e tyre në Hyjin, në familjen, në shoqërinë dhe në rolin që u takon atyre në kishë dhe në kulturën fetare. Kjo ndihmesë do të pasurojë shpirtin dhe do të rrisë efektshmërinë e shkollave të Shoqërisë.

(11) Përshkrimi që ndjek u përket jezuitëve, laikëve dhe fetarëve të tjerë që punojnë në shkollat e Shoqërisë; ai u takon **mësuesve dhe personelit jomësimor, prindërve dhe drejtuesve të këtyre shkollave**. Të gjithë janë të thirrur për një punë të përbashkët me qëllim që tradita injaciane, përshtatur kohës sonë, të jetë më me efikasitet sa më e pranishme në jetën e shkollës dhe të përcaktojë emërtimet bazë dhe praktikën e përditshme.

* * *

Karakteristikat e veprimtarisë edukative të Shoqërisë së Jezusit

SHENIME HYRESE

(12) Megjithëqë shumë karakteristika të përshkruara në këto faqe janë të përbashkëta për çdo formë të veprimtarisë edukative të Shoqërisë së Jezusit,* objekt i veçantë i këtij dokumenti është edukimi bazë i një instituti shkollor të Shoqërisë së Jezusit apo të një kolegji. (Sipas kushteve konkrete të çdo vendi, përveç shkollës së mesme , kolegji mund të përfshijë edhe shkollën fillore). Ata që punojnë në institucione të tjera edukative të jezuitëve, veçanërisht në universitete apo institute studimore të larta, ftohen t'i përshtatin këto karakteristika sipas situatës së tyre të veçantë.

(13) Një përmbledhje e shkurtër e historisë së jetës të Shën Injacit dhe e zhvillimit të edukimit injacian ndodhet në fund të karakteristikave. Leximi i kësaj përmbledhjeje u jep atyre që nuk janë të familjarizuar me historinë e Shën Injacit dhe me fillimet e Shoqërisë së Jezusit një kuptim më të mirë të vizionit shpirtëror nga i cili burojnë karakteristikat edukative të Shoqërisë.

(14) Për të evidentuar raportin midis **karakteristikave të edukimit injacian dhe vizionit shpirtëror të Shën Injacit**, të njëzetetë karakteristikat themelore të numë-

* Përgjithsisht mëtej, për veprimtarinë edukative të Shoqërisë së Jezusit do të themi thjesht 'edukimi injacian'.

ruara në këto faqe janë të ndara në nëntë seksione. Çdo seksion fillon me një pohim që buron nga vizioni injacian dhe vazhdon me karakteristikat edukative që rrjedhin nga ky pohim. Këto karakteristika jepen pastaj në hollësi. Seksioni i dhjetë përshkruan në mënyrë të thjeshtësuar disa karakteristika të pedagogjisë së jezuitëve.

(15) **Pohimet nga nisemi burojnë drejtpërdrejtë nga vizioni që kishte vetë Shën Injaci mbi botën. Karakteristikat e edukimit injacian lindin mbi bazën e reflektimit të këtij vizioni, të aplikuar në punën edukative sipas nevojave të burrave dhe të grave të ditëve tona.** (Vizioni i Shën Injacit mbi botën dhe karakteristikat e edukimit injacian është vendosur në kolona paralele në shtesën e dytë. Shënimet e kësaj shtese tregojnë disa nga burimet e pohimeve skematike të këtij vizioni injacian).

(16) Disa karakteristika kanë të bëjnë me të gjithë bashkësinë edukative, disa të tjera u takojnë, në radhë të parë, disa komponentëve të tij: studentëve, ish-studentëve, mësuesve ose prindërve; kurse disa të tjera që kanë të bëjnë me orientimet dhe zakonet e institucionit si i tillë, u referohen kryesisht drejtuesve të shkollës.

(17) Këto faqe nuk flasin për vështirësitë reale të jetës të të gjithë atyre që i kushtohen veprimtarive edukuese: kundërshtimet e studentëve dhe problemet e tyre disiplinore, vështirësia e ballafaqimit me kërkesat e shumta, shpeshherë me konflikte të përgjegjësve të shkollës, të studentëve, të prindërve dhe të tjerëve; mungesa e kohës për reflektim; dekurajimi dhe zhgënjimet që, me sa duket, janë karakteristikë e punës edukative; dhe as që flitet në këto faqe për vështirësitë që sjell me vete në përgjithësi jeta moderne. Një gjë e tillë nuk bëhet me qëllim për të mohuar apo zvogëluar këto probleme, përkundrazi nuk do të ishte e mundur të flitet për punën edukative të Shoqërisë nëse do të mungonte angazhimi bujar i të gjithë atyre, jezuitë e laikë, që vazhdojnë t'i kushtohen veprimta-

risë edukative, pavarësisht nga shfrytëzimet dhe mossukseset. Ky dokument nuk i vë vetes për detyrë të japë zgjidhje të gatshme për probleme të ndërlikuara.; ai kërkon të ofrojë një vizion të tërësishëm, një frymëzim që t'i japë më shumë kuptim luftës së përditshme dhe të mundësojë përfitime sa më të mëdha.

(18) Përshkrimi i punës edukative të jezuitëve duhet kërkuar në leximin e **plotë të dokumentit**: një lexim i pjesshëm mund të na japë një përfytyrim të gjymtuar që, me sa duket, injoron elementët thelbësore. Angazhimi në besimin që i hap rrugë drejtësisë, p.sh., duhet të përshkojë të gjithë punën edukative të jezuitëve edhe pse ajo nuk është përshkruar në këtë dokument deri tek seksioni i pestë.

(19) Meqë u drejtohem shkollave të mesme të jezuitëve të të gjithë botës, karakteristikat e edukimit injacian janë përshkruar në një formë paksa të përgjithshme dhe skematike, është i nevojshëm një shpjegim i mëtejshëm dhe një aplikim konkret në përshatje me veçoritë vendëse. Prandaj ky dokument nuk duhet marrë si një punë e përfunduar, por kryesisht si një nxitje për një reflektim dhe studim të mëtejshëm.

(20) Jo të gjitha karakteristikat do të jenë të pranishme në të njëjtën masë në çdo shkollë në veçanti: në disa situata, njëri apo tjetri pohim, mund të përbëjë një ideal më tepër se sa një realitet tashmë të pranishëm. Duhet të kemi parasysh “rrethanat e kohës, të vendit, të individëve dhe të faktorëve të tjerë të ngjashëm”.⁷ Në situata të ndryshme, e njëjta thellësi shpirtërore mund të çojë në zbatime të ndryshme konkrete. Për të mënjeluar dallimet që varen nga rrethanat vendëse dhe për të shmangur

përsëritjen e vazhdueshme të shprehjeve të tilla si “kërkohet të jetë”, apo të shprehjes “do të duhej”, karakteristikat janë dhënë në formën e dëftorit, d.m.th., “edukimi injacian është ...”.

(21) **1. Për Shën Injacin, Hyji është Krijuesi dhe Ati, E Mira e Pambaruar, realiteti i vetëm absolut; çdo realitet tjetër buron nga Hyji dhe ka vlerë vetëm në masën që na çon tek Ai.⁸ Hyji është i pranishëm në jetën tonë “duke u lodhur për ne”⁹ në çdo gjë; Ai mund të zbulohet përmes fesë në çdo ngjarje natyrore dhe njerëzore, në tërësinë e historisë dhe në mënyrë të veçantë në jetën e çdo njeriu.**

(22) Edukimi injacian - pohon që bota është pozitive në themel të saj.
- nxit formimin integral të çdo individi brenda bashkësisë njerëzore.
- përfshin një aspekt fetar që përshkon të gjithë veprimtarinë edukative.
- është një mjet apostolik.
- nxit dialogun midis fesë dhe kulturës.

1.1 POHON QE BOTA ESHTË POZITIVE NE THEMEL TE SAJ.

(23) Edukimi i jezuitëve njihet në Hyjin Autorin e çdo realiteti, të çdo të vërtete dhe të çdo njohjeje. Hyji është i pranishëm dhe veprues në gjithësinë e krijuar: në natyrë, në histori dhe tek njerëzit. Prandaj edukimi injacian pohon **mirësinë themelore të botës** “plot me madhësi të Hyjit”,¹⁰ dhe ajo e konsideron çdo element të krijimit si të denjë për studim dhe suditje* nënshtruar një kërkimi që nuk mbaron kurrë.

(24) Në shkollat e jezuitëve veprimtaritë edukative kërkojnë **të zhvillojnë një ndjenjë admirimi e misteri** në zbulimin e krijesës së Hyjit. Një njohje më e plotë e krijimit mund të na çojë në një njohje më të plotë të Hyjit dhe në gatishmëri më të madhe për të punuar me Hyjin

në zhvillimin e krijesës së Tij. Kurset janë trajtuar në atë mënyrë që studentët të ndjejnë gëzim gjatë marrjes së mësimave dhe etje për një njohje përherë dhe më të gjerë e të thellë në mirënjohjen e përvujtë të pranisë së Hyjit.

1.2 FORMIMI INTEGRAL I ÇDO PERSONI BRENDA BASHKESISE.

(25) Hyji na zbulohet në mënyrë të veçantë në misterin e personit njerëzor, “krijuar në përfytyrim dhe në ngjashmëri me Hyjin;¹¹ prandaj edukimi i jezuitëve **eksploron me kujdes kuptimin e jetës njerëzore** dhe angazhohet për formimin integral të çdo studenti si objekt i një dashurie vetjake nga ana e Hyjit. Kështu objekti i edukimit injacian është ai që mbështetet **në zhvillimin sa më të plotë të të gjithë atyre talenteve tek të cilët konkretizohet hap pas hapi dhuntia e Hyjit në secilin si pjesëtar i bashkësisë njerëzore.**

* Kemi të bëjmë me suditje për të fituar dashurinë hyjnore.

(26) **Një formim i plotë dhe i thellë intelektual** përfshin zotërimin e disiplinave bazë humaniste e shkencore, zotërim i cili arrihet përmes një studimi të vëmendshëm dhe këmbëngulës, mbështetur në një mësimdhënie kompetente dhe të motivuar mirë. Ky formim intelektual sjell me vete aftësimin gjithnjë në rritje për të arsyetuar në mënyrë të matur, logjike dhe kritike.

(27) Edukimi injacian, ndërsa vazhdon të nënvizojë rëndësinë e disiplinave humaniste tradicionale, të domosdoshme për kuptimin e personit njerëzor, përfshin

edhe një studim të vëmendshëm e kritik **të teknologjisë, të shkencave shoqërore dhe të atyre natyrore.**

(28) Edukimi injacian në të gjitha disiplinat që jepen në shkollë, i kushton një vëmendje të veçantë zhvillimit **të imagjinatës, të ndjeshmërisë dhe të krijimtarisë** tek çdo student. Këto përmasa pasurojnë marrjen e njohurive duke shmangur në të njëjtën kohë shfaqjet thjesht intelektuale. Ato janë thelbësore për formimin integral të njeriut dhe përbëjnë një mjet të fuqishëm për zbulimin e Hyjit që na shfaqet veçanërisht përmes së bukurës. Për këtë arsye edukimi injacian i jep çdo studenti, përmes procesit mësimor dhe veprimtarive jashtëshkollore, mundësinë të shijojë letërsinë, estetikën, muzikën dhe artet e tjera të bukura.

(29) Shkollat e jezuitëve të shekullit XVII ishin mjaft të njohura për zhvillimin e aftësive të komunikimit, të “gojtarisë”; një gjë e tillë arrihej përmes ushtrimesh të larmishme: studime të shkruara, shfaqje teatrale, ekspozita gojore, ballafaqime mendimesh, etj. Në botën e sotme, aq shumë të influencuar nga mjetet e komunikimit masiv, **zhvillimi i një aftësie reale komunikimi** është ende më e nevojshme se atëherë. Prandaj edukimi injacian kujdeset në mënyrë të veçantë për aftësitë tradicionale të të folurit dhe të shkruarit dhe gjithashtu kërkon të ndihmojë studentët në përdorimin, me sa më shumë lehtësi, të këtyre mjeteve moderne të komunikimit siç janë filmi dhe televizioni.

(30) Në botën e sotme është e rëndësishme të ndërjegjësohemi për **ndikimin** mbytës të mass medias në qëndrimet dhe mënyrat e të trajtuarit e njerëzve dhe të

kulturave. Kështu edukimi injacian përmban programe që i bëjnë njerëzit të aftë të kuptojnë dhe të **peshojnë** në mënyrë kritike **këtë ndikim të mass medias**. Këto mjete të jetës moderne, përmes një edukimi korrekt, mund të ndihmojnë burrat dhe gratë të rrisin bashkësinë e tyre dhe jo të ndodhë e kundërta.

(31) Edukimi në tërësi i personit nënkupton një zhvillim fizik në harmoni me shfaqjet e tjera të procesit edukativ. Prandaj edukimi injacian përfshin një program të vlefshëm **veprimtarish sportive dhe të edukimit fizik**. Praktika sportive, përveçse rrit rezistencën e trupit, ndihmon të rinjtë të pranojnë me qetësi sukseset dhe mossukseset, i bën më të vetëdijshëm për nevojën e bashkëpunimit me të tjerët, duke vënë në shërbim të së mirës së përbashkët cilësitë më të mira të çdo individi.

(32) Të gjitha shfaqjet e ndryshme të procesit edukativ kanë një qëllim të vetëm: formimin e një **personi të ekuilibruar**, të pajisur me përfytyrimin e një jete të përpunuar individualisht që nënkupton zotërimin e aftësive reflektuese. Për të ndihmuar këtë formim, të gjitha kurset ndërliidhen midis tyre brenda një programi edukativ të hartuar me shumë kujdes. Çdo aspekt i jetës së shkollës ndihmon në zhvillimin tërësor të çdo personi të veçantë.¹²

(33) Meqë humanizmi i vërtetë arrihet vetëm në marrëdhëniet me të tjerët që nënkupton qëndrime respekti, dashurie dhe shërbimi, edukimi injacian nënvizon dhe ndihmon zhvillimin **e rolit të çdo personi si pjestar i bashkësisë njerëzore**. Studentët, profesorët dhe të gjithë pjesëtarët e bashkësisë edukative të

vendosin në marrëdhënie me të tjerët një solidaritet që hedh vështrimin tej ndryshimeve racore, kulturore dhe fetare. Në një institut të mbajtur nga jezuitët kërkohet një edukim i mirë; të gjithë duhet të jetojnë e të punojnë së bashku në një atmosferë mirëkuptimi dhe dashurie të ndërsjelltë, duke respektuar që të gjithë, burra e gra, si bij të Hyjit.

1.3 ASPEKTI FETAR PERSHKON TE GJITHE VEPRIMTARINE EDUKATIVE.

(34) Meqenëse çdo element i programit edukativ mund të shërbejë si mjet për zbulimin e Hyjit, të gjithë mësuesit ndajnë përgjegjësinë e aspektit fetar të edukimit. Por kjo nuk përjashton faktin që në integrimin e procesit të zbulimit të Hyjit dhe në kuptimin e thelbit të vërtetë të jetës njerëzore, faktori përcaktues është teologjia dhe paraqitja e saj në programet e **formimit fetar dhe shpirtëror**. Ky formim bën pjesë të pashkëputur në edukimin injacian; ai nuk duhet të përbëjë një shtojcë për të qenë brenda në procesin edukativ dhe as që duhet të qëndrojë i ndarë nga ai.

(35) Edukimi injacian kërkon të favorizojë krijimtarinë e Shpirtit të Hyjit që është aktiv tek çdo njeri. Ai mundëson rastet për një **përgjigje feje** ndaj Hyjit, pavarësisht se feja nuk mund të detyrohet.¹³ Në të gjithë kurset, në atmosferën e përgjithshme të shkollës, dhe në mënyrë të veçantë në kurset me karakter fetar, duhet të bëhen të gjitha përpjekjet për të paraqitur përgjigjen e fesë ndaj Hyjit si diçka autentike njerëzore dhe jo në kontrast me kërkesat e arsyes; të çohen më tej vlerat që janë në gjendje t'i kundërvihen shekullarizimit

të jetës moderne. Një shkollë e jezuitëve bën ç'është e mundur për të marrë përsipër zbatimin e misionit caktuar Shoqërisë së Jezuitëve për t'u "**bërë ballë** me të gjitha fuqitë formave të shumëllojshme të **ateizmit** bashkëkohor".¹⁴

(36) Çdo aspekt i procesit edukativ mund të çojë përfundimisht drejt **adhurimit të Hyjit** i pranishëm e veprues në gjithësinë e krijuar dhe për të **patur një respekt të përvujtë për gjithësinë** si refleksi i Hyjit. Në një shkollë të jezuitëve ky adhurim dhe ky respekt bëjnë pjesë në jetën e bashkësisë edukative; ato shprehen me anë të lutjes vetjake dhe në celebrimet e përshtatshme fetare të përbashkëta. Inteligjenca, imagjinata dhe ndjeshmëria, efektshmëria fizike dhe ndjenja e admirimit të nxitura në çdo kurs dhe në të gjitha shfaqjet e jetës në shkollë, të gjitha këto ndihmojnë studentët në zbulimin e Hyjit, veprues në histori dhe në gjithësi.

1.4. NJE MJET APOSTOLIK.¹⁵

(37) Me gjithë respektin e plotë për të gjitha disiplinat shkollore, objekti qendror i edukimit injacian është **përgatitja për jetën**, ushtrim që është dhe ai vetë, përgatitje për jetën e amshuar. Formimi i individit nuk është një qëllim i përcaktuar në mënyrë abstrakte; edukimi injacian interesohet edhe për mënyrën me të cilën studentët e shfrytëzojnë formimin e tyre brenda bashkësisë njerëzore, në shërbim të të tjerëve, "për

lavdinë, nderimin dhe shërbimin ndaj Hyjit".¹⁶ Efektshmëria e edukimit të jezuitëve nuk matet me termin e punimeve akademike të studentëve apo me kompetencat profesionale të mësuesve, por më tepër në terma të kësaj cilësie jete.

1.5. DIALOGU MIDIS FESE DHE KULTURES.

(38) Me besimin që Hyji është aktiv në të gjithë botën e krijuar dhe në të gjithë historinë njerëzore, edukimi injacian **nxit dialogun midis fesë dhe kulturës** që përfshin dialogun midis **fesë dhe shkencës**. Ky dialog presupozon që personat dhe strukturat kulturore janë njerëzore, të papërfunduara dhe në disa raste të rënduara me mëkate dhe, si të tilla, kanë nevojë të bëjnë kthesë, të ndërrohen;¹⁷ në të njëjtën kohë ai zbulon Hyjin që na shfaqet në mënyra të shumëllojshme dhe të diferencuara. Prandaj edukimi i jezuitëve nxit kontaktet me kulturat e tjera dhe fton studentët t'i çmojnë sinqerisht për të njohur në mënyrë kritike dhe krijuese kontributet dhe mangësitë e çdo njëres prej tyre.

(39) Edukimi injacian u përshtatet kërkesave të veçanta të vendit dhe të kulturës në të cilat vepron shkolla;¹⁸ kjo aftësi përshtatjeje, ndërsa nxit një "patriotizëm të shëndoshë", nuk qëndron në pranimin aprioristik të vlerave kombëtare. Koncepti i "kontaktit me", "stima e sinqertë" dhe "mënyra kritike dhe krijuese" i referohet edhe kulturës, edhe vendit tënd. Qëllimi i fundit është gjithnjë zbulimi i Hyjit, i pranishëm dhe aktiv në botën e krijuar dhe në histori.

– i lirë të veprojë në bazë të fesë drejt asaj lumturie që është qëllimi i jetës: i lirë për t`u sakrifikuar me të tjerët në shërbim të Mbretërisë së Hyjit për shpëtimin e gjithësisë.

(41)	Edukimi injacian	- vë theksin në kujdesin e veçantë që duhet të kemi për çdo njeri. - nënvizon rolin aktiv të studentit. - zhvillon dëshirën për të mësuar vazhdimisht gjatë gjithë jetës.
------	------------------	---

2.1. KUJDES I VEÇANTE PER ÇDO NJERI.

(40) **2. Çdo njeri është personalisht i njohur dhe i dashur nga Hyji. Kjo dashuri fton për një përgjegje, por që një përgjegje të jetë automatikisht njerëzore, duhet të jetë e lirë. Prandaj, për t`iu përgjigjur dashurisë së Hyjit njeriu duhet të jetë:**

– i lirë për të thënë të vërtetën dhe për të pranuar përgjegjësitë e veprimeve të veta dhe pasojat e tyre: i lirë të jetë besnik

(42) Të rinjtë që ndjekin një shkollë të jezuitëve nuk kanë arritur akoma pjekurinë e plotë. Procesi edukativ **njeh etapa të ndryshme zhvillimi** intelektual, ndjesor dhe shpirtëror dhe ndihmon studentët të arrijnë gradualisht pjekurinë në të gjitha këto aspekte. Prandaj **plani mësimor është përqëndruar mbi personin** më shumë se në argumentet që do të transmetohen. Për më tepër, çdo studenti i krijohen kushtet për zhvillimin dhe realizimin e objektivave të shtruarra me një **ritëm në përshtatje me aftësitë e tij vetjake** dhe karakteristikat e personalitetit të tij.

(43) Ecuria në përdorimin e përgjegjshëm të lirisë lehtësohet nga **lidhjet vetjake midis studentëve dhe profesorëve**. Mësuesit dhe drejtuesit, qofshin këta

jezuitë apo laikë, janë më shumë se udhëheqës akademikë: ata janë të përfshirë në jetën e studentëve, interesohen personalisht për ecurinë e të riut në drejtimin intelektual, ndjesor, moral e shpirtëror dhe ndihmojnë secilin për të patur një vetëdije të drejtë për vetveten dhe për t'u bërë një person i përgjegjshëm brenda bashkësisë. Duke respektuar plotësisht “privacy” e studentëve, të rriturit janë të gatshëm të dëgjojnë interesat dhe shqetësimet e tyre në lidhje me kuptimin e jetës, të ndajnë së bashku gëzimet dhe hidhërimet, t'i ndihmojnë në hapat që bëjnë për ngritjen vetjake dhe në lidhjet ndërpersonale. Me këto dhe mënyra të tjera, të rriturit e bashkësisë edukative udhëheqin studentët drejt konsolidimit të atyre vlerave që përbëjnë bazën e zgjedhjeve në jetë dhe që, duke tejkaluar kufijtë e “unit”, kërkojnë t'u përgjigjen nevojave të tjerëve. Të rriturit e bashkësisë edukative përpiqen ta ndërtojnë jetën e tyre në atë mënyrë që të jetë shembull për nxënësit: ata janë të gatshëm t'i bëjnë pjesëmarrës të përvojave të tyre jetësore. “**Cura personalis**” (kujdes dhe interes për çdo njeri) mbetet një karakteristikë themelore e edukimit të jezuitëve.¹⁹

(44) **Liria nënkupton disa përgjegjësi brenda bashkësisë.** “Cura personalis” nuk kufizohet vetëm në lidhjet midis nxënësit dhe profesorit: ajo përmban planin mësimor dhe të gjithë periudhën e studimeve; pjesëtarët e bashkësisë edukative interesohen për njëri-tjetrin dhe mësojnë nga njëri-tjetri. Lidhjet vetjake midis studentëve si dhe midis të rriturve, – laikë dhe jezuitë, drejtues, pesoneli mësimor dhe jomësimor – kërkojnë të evidentojnë pikërisht këtë qëndrim të ndërsjelltë. Kujdesi për njeriun në veçanti shtrihet edhe në drejtim të ish-

nxënësve, të prindërve dhe nxënësit apo nxënëses në gjirin e familjeve të tyre.

2.2. ROLI AKTIV I STUDENTEVE NE PROCESIN E PERVETESIMIT TE MESIMEVE.

(45) Ecuria për të arritur pjekurinë dhe pavarësinë, të domosdoshme për t'u rritur në liri, nënkupton një **pjesëmarrje aktive** më shumë se një pranim pasiv. Midis hapave të rëndësishëm që përcaktojnë këtë rol aktiv të studentëve kujtojmë: **studimin vetjak, angazhimet kërkimore dhe krijuese vetjake** dhe një qëndrim këmbëngulës reflektimi. Është detyrë e mësuesit të ndihmojë studentin të bëhet subjekt që përvetëson në mënyrë të pavarur dhe që shkon duke marrë përgjegjësinë e edukimit të tij.

2.3. DESHIRE KONSTANTE FORMIMI.

(46) Edukimi është një proces që zgjat gjithë jetën, prandaj edukimi i jezuitëve përpiqet të krijojë gëzimin e përvetësimin të njohurive dhe dëshirën për të mësuar edhe pas viteve shkollore. “Ndoshta më shumë se edukimi që u japim nxënësve tanë, kanë vlerë aftësia dhe dëshira që duhet të ngulitim tek ata për të vazhduar pa ndërprerje formimin e tyre. Është i rëndësishëm përvetësimi i njohurive, por më e rëndësishme është kërkesa dhe dëshira për të vazhduar studimet gjatë gjithë jetës”.²⁰

(47) Lidhjet vetjake me studentët do të ndihmojnë të rriturit e bashkësisë edukative të jenë **të hapët për çdo ndryshim dhe të vazhdojnë të mësojnë**; në këtë mënyrë do të jenë më efikas në punën e tyre. Një gjë e tillë është veçanërisht e rëndësishme sot, duke patur parasysh ndryshimet e shpejta të kulturës dhe vështirësitë që të rriturit mund të kenë në kuptimin dhe interpretimin korrekt të presioneve kulturore, objekt i të cilave janë të rinjtë.

(48) Edukimi injacian konstaton se pjekuria intelektuale, ndjesore e shpirtërore vazhdon gjatë gjithë jetës; të rriturit e bashkësisë edukative nxiten të thellohen në të gjitha këto aspekte dhe u jepen atyre programe të përhershme formimi për t'i ndihmuar ata në këtë pjekuri.²¹

(49) **(3) Për shkak të mëkatit dhe të rrjedhëve të tij, liria për t'iu përgjigjur dashurisë së Hyjit nuk është automatike. Me ndihmën dhe forcën, që vijnë nga dashuria e Hyjit shpëtimtar, ne jemi të angazhuar në një luftë të vazhdueshme me qëllim që të njohim dhe të mënjanojmë pengesat që na dalin përpara në arritjen e lirisë së vërtetë – përfshirë rrjedhojat e mëkatit – dhe në zhvillimin e aftësive të nevojshme për ushtrimin e lirisë së vërtetë.**

a. *Kjo liri kërkon një njohje autentike, një dashuri dhe një pranim të vetvetes, që lidhen me përkushtimin për të qenë të lirë nga çdo lidhje e tepërt me të mirat materiale, stimën, shëndetin, pushtetin dhe çdo gjë tjetër, deri me vetë jetën tonë.*

b. *Liria e vërtetë kërkon një njohje realiste të forcave të ndryshme të pranishme në botën që na rrethon; ajo përfshin shkëputjen nga perceptimet e shtrembëta të realitetit, nga vlerat e tjetërsuara, nga qëndrimet e ngrira dhe nga pozicionet e ngushta ideologjike.*

c. *Për të arritur lirinë e vërtetë duhet të mësojmë të njohim dhe të çmojmë influksat që e ndihmojnë apo e pengojnë atë: valët e zemrës sonë, përvojat e kaluara të çdo tipi, marrëdhëniet reciproke me të tjerët, dinamikat e historisë, të strukturave sociale dhe të kulturës.*

(50) Edukimi injacian	- është një edukim në vlera. - nxit njohjen realiste, dashurinë dhe pranimin e vetvetes. - pajis me njohjen realiste të botës në të cilën jetojmë.
-----------------------	--

3.2. REALIZEM I SHENDOSHE NE NJOHJE, DASHURI DHE PRANIIM I VETVETES.

3.1. EDUKIM NE VLERAT.

(51) Edukimi i jezuitëve kujdeset për formimin në vlerat, edukimin e qëndrimeve dhe nxit pareshtur aftësinë në përdorimin e kriterëve vlerësues; me një fjalë ai ka për qëllim formimin e vullnetit. Meqë njohja e së mirës dhe e së keqes dhe e të mirave të ndryshme në hierarkinë e tyre është e domosdoshme për njohjen e influksëve të ndryshme që veprojnë mbi lirinë dhe në ushtrimin e saj, edukimi ka në bazën e tij një kontekst moral: **njohja është e pandarë nga ushtrimi i virtytit.**

(52) Zhvillimi vetjak ecën krahas formimit të karakterit dhe vullnetit, me kapërcimin e egoizmit, të mungesës së vëmendjes për të tjerët dhe të efekteve të tjera të mëkatit; me zhvillimin e një lirie që të respektojë të tjerët dhe të marrë përsipër përgjegjësitë, gjë që nënkupton **rregullore** të domosdoshme për çdo shkollë duke përfshirë dhe **sistemin disiplinor**. Një rëndësi të njëjtë ka edhe **vetëdisiplina** që i kërkohet studentëve lidhur me ndershmërinë intelektuale, aplikimin e një studimi këmbëngulës dhe serioz dhe në sjelljen me të tjerët mbi bazën e njohjes së dinjitetit të çdo qenieje njerëzore.

(53) Një institut mësimor i Shoqërisë së Jezusit e konsideron më se të ligjshëm krijimin e një atmosfere kërkimesh në të cilën sistemi i vlerave arrihet përmes një procesi peshimi të këndvështrimeve të ndryshme.

(54) Vëmendja për zhvillimin integral të njeriut, krijesë e Hyjit, ky humanizëm kristian në edukatën injaciane, nënvizon që përdorimi i përgjegjshëm i lirisë na çon drejt një jete me të vërtetë të lumtur, por njëkohësisht njih edhe **realitetin e mëkatit dhe të rrjedhojave të tij** në jetën e çdo njeriu. Prandaj edukimi injacian nxit studentin që ta shohë me çiltërsi këtë pengesë në realizimin e lirisë, në kuadrin e njohjes së vetvetes dhe të bindjes në rritje që falja dhe kthimi janë të mundshëm përmes dashurisë dhe ndihmesës së Hyjit²².

(55) Lufta për të mënjanuar pengesat e lirisë dhe zhvillimin e ushtrimit të saj shkon shumë më tej se sa njohja e efekteve të mëkatit; është gjithashtu e domosdoshme një përpjekje e vazhdueshme për të njohur **të gjitha pengesat që vështirësojnë këtë pjekuri.**²³ Studentët ndihmohen si në drejtim të përpjekjeve të tyre për të njohur çdo formë paragjykimi dhe shikimi të ngushtë, nga ana tjetër të matit relativitetin e çdo të mire që na propozohet e të vlerësojnë* midis vlerave në konkurrim.

(56) Mësuesit dhe drejtuesit u qëndrojnë afër nxënësve në këtë proces pjekurie, janë të gatshëm t'i ndihmojnë që përmes diskutimeve **të reflektojnë mbi përvojat vetjake** në mënyrë që të arrijnë të kuptojnë

* Për Injacin “**të vlerësosh**” do të thotë

- të sqarosh motivet dhe arsyet që që ndrojnë pas gjykimeve të tua;
- të vlerësosh shkaqet e implikimet e përvojave të tua;

- të peshosh zgjidhje të mundshme;
- të zbulosh atë që më mirë të çon në qëllimin e dëshiruar; [Referonju n.(47) nga “Pedagogjia injaciane”].

“**Të vlerësuarit**” konsiston në

- të njohësh të dhënat e faktit;
 - të reflektosh;
 - të përzgjedhësh motivet që na shtyjnë;
 - të shqyrtosh vlerat dhe prioritetet;
 - të konsiderosh ndikimin që një vendim mund të ketë tek të varfërit;
 - të vendosësh zgjidhjet e tua;
 - të jetosh “ ”;
- [Referonju n.(135) nga “Pedagogjia injaciane”].

Gjatë punës së përkthimit ne kemi kërkuar fjalët më të përshtatshme, që shprehin më mirë kuptimin e gjërë të këtij termi. Kemi gjetur këto fjalë më të përafërta si: dallim, gjykim, vështrim, përzgjedhje, veprim me urtësi, vlerësim.

Në fund kemi menduar të përdorim në të gjitha pjesët termin “të vlerësosh”, sepse na duket më i përshtatshëm për të shprehur kuptimin e pasur të tij.

përvojën e vet në Hyjin: çdo njeri, ndërsa pranon dhe zhvillon dhuntitë e veta, njih gjithashtu kufizimet e veta dhe përpiqet, për aq sa ka mundësi, t'i kapërcejë ato. Programi edukativ, ndërsa udhëheq nxënësit drejt kësaj njohjeje reale të vetvetes, kërkon t'i ndihmojë në njohjen e këtyre influksëve të ndryshme dhe në **zhvillimin e një sensi kritik** që shkon shumë më larg se njohja e thjeshtë e së drejtës dhe e jo të vërtetës, të asaj që është e mirë dhe të asaj që është e keqe.

3.3 NJE NJOHJE REALISTE E BOTES.

(57) Një njohje realiste e krijimit të botës hap sytë mbi mirësinë e veprimit të Hyjit, por sjell me vete edhe **ndërgjegjësimin e efekteve sociale të mëkatit:**

papërsosmërinë themelore, padrejtësinë dhe nevojën e shëlbimit të çdo njeriu, në çdo kulturë, në çdo strukturë njerëzore. Duke u përpjekur të zhvillojë këtë aftësi arsyetimi reflektiv, edukimi injacian nënvizon nevojën për të rënë në kontakt me botën ashtu siç është, d.m.th., me një botë që ka nevojë të transformohet, pa qenë nevoja të mohojmë thellësinë e mirësisë së krijimit.

(58) Edukimi i jezuitëve kërkon kështu të zhvillojë tek studentët aftësitë e njohjes së reales dhe të peshimit kritik të saj. Ky ndërgjegjësim nënkupton **bindjen që njerëzit dhe strukturat mund të ndryshojnë**, përfshin **vendimin dhe angazhimin për të punuar për realizimin e këtyre ndryshimeve**, për të ndihmuar në ndërtimin e strukturave njerëzore më të drejta, që bëjnë të mundur ushtrimin e lirisë, ndërtuar mbi njohjen gjithnjë e më të gjerë të dinjitetit njerëzor të të gjithëve pa përjashtim.²⁴

(59) **4. Vizioni i botës së Injacet është përqëndruar mbi personin historik të Jezu Krishtit. Ai, me përgjigjen e plotë që i jep dashurisë së Hyjit duke u vënë në shërbim të tjerëve, është modeli për jetën e njerëzve. Ai ndan me ne kushtet njerëzore dhe na fton ta ndjekim nën flamurin e kryqit²⁵ me një përgjigje dashurie ndaj Hyjit. Ai është i gjallë midis nesh dhe mbetet përgjithnjë Njeriu për të tjerët në shërbim të Hyjit.**

(60) Edukimi injacian - propozon Krishtin si model të jetës së njerëzve.

- realizon një kujdes baritor të përshtatshëm me lutjen vetjake dhe të përbashkët, në adhurim dhe në shërbim.

4.1. KRISHTI ESHTË MODELI.

(61) Në bashkësinë edukative të shkollave të jezuitëve të sotëm janë të pranishëm njerëz me fe dhe kultura të ndryshme; të gjithëve, pavarësisht nga besimi i tyre, Krishti na jepet si model i jetës së njerëzve. Të gjithë kanë mundësi të frymëzohen dhe të gjejnë orientimet për angazhimin e tyre në jetë dhe në mësimet e Krishtit. Ai është dëshmitari i dashurisë dhe i faljes së Hyjit, bëhet i afërm për të gjithë ata që vuajnë dhe vë jetën e tij në shërbim të tjerëve. Çdo njeri mund ta **imitojë, duke hequr dorë nga vetvetja** dhe duke pranuar vështirësitë dhe vuajtjet që lindin gjatë rrugës për të arritur të vetmin qëllim që i kemi vënë para vetes: përgjigjen e vullnesës së Hyjit në shërbim të tjerëve.

(62) Të krishterët pjesëtarë të bashkësisë edukative kërkojnë me vendosmëri **miqësinë vetjake** me Krishtin, që na dhuroi faljen dhe lirinë e vërtetë përmes vdekjes dhe ringjalljes së tij dhe që sot është i pranishëm dhe aktiv në jetën tonë. Të jesh “I Krishterë” don të thotë **të ndjekësh** Krishtin duke u bërë i ngjashëm me të; don të thotë të pranosh stilin e tij të jetës dhe të vësh në lëvizje vlerat e tij për aq sa është e mundur.²⁶

4.2. KUJDES BARITOR.²⁷

(63) Veprimtaria baritore është një aspekt i “cura personalis”, që lejon **farën e fesë dhe të angazhimit fetar** të piqet tek çdo njeri, duke e bërë të aftë të njohë dhe t’i përgjigjet mesazhit të dashurisë së Hyjit; njohjes së Hyjit të pranishëm dhe aktiv në jetën tonë, në jetën e të tjerëve dhe në të gjithë rruzullin, do t’i korrespondojë një angazhim shërbimi brenda bashkësisë. Në një shkollë jezuitësh, çdo pjesëtar i bashkësisë edukative, i ofrohet një kujdes baritor i përshtatshëm, me qëllim që ky angazhim vetjak i lindur nga feja të rritet dhe të forcohet.

(64) Për kristianët veprimtaria baritore është e përqëndruar në personin e Krishtit, i pranishëm në bashkësinë kristiane. Veprimtaria baritore ndihmon studentët të takojnë personin e Krishtit si mik dhe udhëheqës, të fitojnë përvojë në Shkrimin e Shenjtë, në celebrimet e sakramendeve, në lutjen vetjake dhe të përbashkët, në punë, në lojë e ndër njerëz të tjerë; në shërbimin ndaj vëllezërve arrihet duke imituar Krishtin, Njeriun për të tjerët.²⁸

(65) Përvoja e “Ushtrimeve shpirtërore”²⁹ është e nxitur si rrugë për të njohur sa më thellë Krishtin, për ta dashur dhe për ta ndjekë. “Ushtrimet” kanë për të ndihmuar edhe pjesëtarët e bashkësisë edukative për të patur një vizion të qartë për Shën Injacin, shpirtin që është në bazën e edukimit injacian. “Ushtrimet” mund të bëhen në disa mënyra, përshtatur kohës në dispozicion dhe mundësive të secilit, i ri apo i rritur.

(66) Në shkollën e jezuitëve çdo student nxitet dhe ndihmohet **për t’iu përgjigjur thirrjes vetjake që i bën Hyji, një thirrje** shërbimi në jetën vetjake e

profesionale, në martesë, në jetën meshtarake apo rregulltare apo në jetën e beqarisë.

4.3. LUTJA VETJAKE DHE CELEBRIMI I FESE.

(67) Lutja është një shprehje e fesë dhe një mjet efikas për të vendosur me Hyjin një lidhje vetjake që të çon tek një angazhim shërbimi. Edukimi injacian ofron një fillesë progresive drejt lutjes duke ndjekur shembullin e Krishtit që rregullisht i lutej Atit të tij. Të gjithë janë të joshur të lavdërojnë dhe të falenderojnë Hyjin me lutje, për t'u lutur për njëri-tjetrin brenda bashkësisë dhe për të lypur ndihmën e Hyjit për nevojat e bashkësisë më të madhe njerëzore.

(68) Lidhja me Hyjin në fe ka shfaqje vetjake dhe të përbashkëta; bashkësia edukative në një shkollë jezuitësh është bashkuar me lidhje më të forta se sa ato thjesht njerëzore: ajo është një **bashkësi e mbështetur në fe** dhe këtë fe e shpreh me celebrime të përshtatshme fetare dhe shpirtërore. Për katolikët, sakramenti i Eukaristisë është celebrimi i një bashkësie besimtarësh të përqëndruar të Krishtit. Të gjithë pjesëtarët e rritur të bashkësisë janë të nxitur për të marrë pjesë në këto celebrime, jo vetëm për të shprehur fenë e tyre vetjake, por edhe për të dhënë dëshmi për vlerat e shkollës.

(69) Pjesëtarët katolikë të bashkësisë edukative celebrjnë dashurinë mëshiruese të Hyjit, duke e marrë me Sakramendin e Ripajtimit. Sipas rrethanave vendëse, shkolla e jezuitëve përgatit studentët (apo edhe të rriturit) për të marrë Sakramendet e tjera.

(70) Dëgjesa e Krishtit në Atin e tij e ka çuar në dhurimin e plotë të vetvetes në shërbim të tjerëve: lidhja me Hyjin nënkupton në mënyrë të pashmangshme një lidhje korresponduese me të tjerët.³⁰ Edukimi i jezuitëve ka për qëllim një **fe, që është e përqëndruar në personin historik të Krishtit**, një fe që të **çon në angazhimin** për të imituar Krishtin, Njeriun për të tjerët.

(71) ***5. Një përgjigje ndaj dashurisë së Hyjit, e lirë dhe që zë fill nga dashuria, nuk mund të jetë thjesht spekulluese dhe teorike. Me çdo kusht parimet spekulluese duhet të çojnë në një veprim vendimtar: “dashuria shprehet me vepra”.³¹ Shën Injaci kërkon nga burrat dhe gratë një angazhim tërësor dhe aktiv. “Për t'i përngjarë Krishtit e të jesh me të vërtetë si ai”³² duhet të kthejmë në praktikë idealet tona në realitetin familjar, në punë, në lëvizjet shoqërore, në strukturat juridike dhe në veprimtaritë fetare, në politikë.³³***

(72) Edukimi injacian - përgatit për një angazhim aktiv në jetë.

- është në shërbim të një feje që nxit drejtësinë; kërkon të formoje burra dhe gra për të tjerët”.
 - tregon një vëmendje të veçantë për të varfërit.

5.1. ANGAZHIM AKTIV NE JETE.

(73) “Dashuria tregohet me vepra”: përgjigja e lirë dhe që zë fill nga dashuria që njeriu i fal dashurisë shëlbuese të Hyjit, shndërrohet në një jetë shërbimi aktive. Edukimi i jezuitëve në etapa progresive, që marrin parasysh zhvillimin gradual të pjekurisë dhe pa asnjë përpjekje manipulimi, nxit formimin e burrave dhe të grave, që dijnë të mishërojnë në jetë fenë dhe orientimet e tyre. “Ne... iu bëjmë këtë sfidë: kërkojmë t’iu stimulojmë për të vënë në praktikë me veprimtari konkrete vlerat që ju çmoni, vlerat që keni marrë gjatë formimit tuaj”.³⁴

5.2. EDUKIM I NJE DIAKONIE FETARE QE NXIT DREJTESI.³⁵

(74) “Veprimi vendimtar” që kërkon koha jonë është **feja që nxit drejtësinë**: “Misioni i Shoqërisë së Jezusit sot është shërbimi i fesë për të cilën nxitja e drejtësisë përbën kërkesën absolute, sepse pajtimi me Hyjin kërkon pajtimin e njerëzve midis tyre”.³⁶ Nxitja e një feje që realizon drejtësinë është të vepruarit duke imituar Krishtin; kemi të bëjmë me drejtësinë që është **gjallëruar nga dashuria ungjillore**: “Është dashuria që i jep forcë fesë dhe dëshirës për drejtësi. Drejtësia nuk

arrin plotësinë e saj të brendshme përveçse në dashuri. Dashuria kristiane përfshin dhe thëllon kërkesat e drejtësisë, duke u dhënë atyre një motivim të ri dhe një forcë të re të brendshme. Drejtësia pa dashurinë nuk është ungjillore”.³⁷ Mbretëria e Hyjit është mbretëria e drejtësisë, e dashurisë dhe e paqes.³⁸

(75) Nxitja e drejtësisë përfshin, si komponent të domosdoshëm, **veprimin në favor të paqes**. Nuk kemi të bëjmë vetëm me mungesën e luftës: veprimi në favor të paqes kërkon krijimin midis të gjithë njerëzve të lidhjeve të dashurisë dhe të besimit të ndërsjellë.

(76) Qëllimi synues i fesë që nxit drejtësinë dhe punon për paqen, është **një tip i ri njeriu në një tip të ri shoqëror**; një shoqëri në të cilën çdo njeri merr përsipër përgjegjësinë nxitëse të zhvillimit të të tjerëve. Angazhimi veprues që u kërkohej studentëve – i jetuar tashmë nga ish-nxënësit dhe të rriturit e bashkësisë edukative – sjell me vete një pjesëmarrje të lirë në përpjekjet për të ndërtuar një botë më humane dhe një bashkësi të formuar nga dashuria. Për të krishterët ky angazhim është një përgjigje ndaj thirrjes së Krishtit, dhe çohet përpara me bindjen e përvuajtur se kthimi është i mundur vetëm me ndihmën e Hyjit. Për ata Sakramendi i Pajtimin është një komponent i domosdoshëm i kësaj përpjekjeje për paqen dhe drejtësinë. Por të gjithë pjesëtarët e bashkësisë edukative, dhe ata që nuk janë të fesë kristiane, mund të bashkëpunojnë për arritjen e këtij qëllimi. Njohja autentike e vetëdijshme e dinjitetit njerëzor mund të përbëjë pikënisjen e përbashkët për të punuar së bashku në kërkimin e drejtësisë dhe mund të përbëjë fillimin e një dialogu ekumenik që njeh lidhjen e ngushtë midis drejtësisë dhe fesë.

(77) Në një shkollë të Shoqërisë theksi është vënë mbi **edukimin** në drejtësinë. Njohuritë e përshtatshme të bashkuara me zakonet e të menduarit në mënyrë të përpiktë dhe kritike lehtësojnë vendimin për t'u angazhuar me forcë për drejtësinë në moshën e rritur. Përveç këtij formimi bazë të domosdoshëm, kërkesa për drejtësi në një kontekst edukativ paraqet tri pamje të dallueshme:

(78) **1. Problemet e drejtësisë janë të pranishme në curriculumin e jetës shkollë.** Në disa raste një gjë e tillë kërkon krijimin e kurseve të reja; por është e një rëndësie më të madhe vëmendja ndaj përmasave të drejtësisë, gjithnjë të pranishme, në mësimdhënien e të gjitha disiplinave.³⁹ Mësuesit kërkojnë të bëhen më të vetëdijshëm për këto përmasa, në mënyrë që të mund t'u japin studentëve atë formim intelektual, moral dhe shpirtëror që do t'i bëjë të aftë të angazhohen në shërbim, t'i bëjë veprimtarë dhe nismëtarë të ndryshimeve. Curriculumi i jetës shkollë përfshin një **analizë kritike të shoqërisë** në përshtatje me moshën e studentëve; bën pjesë në këtë analizë një shtesim i zgjidhjes koherente me parimet kristiane. Pikat referuese janë Fjala e Hyjit, mësimet e Kishës, shkencat njerëzore.⁴⁰

(79) **2. Në një institucion të jezuitëve linjat e veprimit dhe programet japin një dëshmi praktike të një feje që nxit drejtësinë;** duhet të dëshmojmë

vlera të kundërta me ato të shoqërisë së konsumit. Analiza sociale e kontekstit në të cilin është vendosur shkolla, mund të çojë në një vetëvlerësim të institucionit, që mund të kërkojë ndryshime strukturore në orientimet dhe në praktikën e shkollës.⁴¹ Projektet edukative dhe praktika e përditshme e shkollës nxisin respektin e ndërsjelltë, nxisin dinjitetin njerëzor të të gjithëve, të rritur e të rinj, respektojnë të drejtat e çdo njeriu të bashkësisë edukative.

(80) **3. “Nuk mund të ketë kthim të vërtetë në drejtësi nëse mungojnë veprat e drejtësisë”.**⁴² Lidhjet ndërvetjake në shkollë shprehin një vëmendje të thellë për drejtësinë dhe dashurinë. Për të përgatitur një angazhim në jetë, edukimi inxian jep raste kontaktesh reale me botën e padrejtësisë. Analiza e shoqërisë e mësuar në curriculumin e jetës shkollë shndërrohet kështu në refleksione të bazuara në kontaktin real me përmasat strukturore të padrejtësisë.

(81) Pjesëtarët e bashkësisë edukative janë të **vetëdijshëm dhe të përfshirë në problemet e mprehta të kohës sonë.** E tërë bashkësia edukative, dhe në të çdo njeri, është e ndërgjegjshme për ndikimin që mund të ketë tek të tjerët; vija politike e shkollës përcaktohet në ndërgjegjen e efekteve të saj të mundshëm e mbi një bashkësi më të gjerë dhe mbi strukturat e saj shoqërore.

5.3. BURRA E GRA PER TE TJERET.⁴³

(82) Edukimi injacian ndihmon studentët për të kuptuar se **talentet janë dhunti që duhen zhvilluar** jo për kënaqjen e vetvetes as për përfitim vetjak, por kryesisht, me ndihmën e Hyjit, **për të mirën e bashkësisë njerëzore**. Studentët nxiten për të vënë dhuntitë e veta në shërbim të tjerëve për dashuri të Hyjit:

“Objektivi i parë i veprimtarisë sonë edukative është sot ai i formimit të burrave dhe grave për të tjerët; burra e gra që nuk jetojnë për vete, por për Hyjin dhe Krishtin–Njeri–Hyj të tij, që ka vdekur dhe është ngjallur për të gjithë botën. Burra për të tjerët, të paaftë të konceptojnë një dashuri ndaj Hyjit që të mos përfshijë dashurinë për vëllanë e tyre të fundit; një dashuri efikase, që ka si kërkesë të parë drejtësinë, e vetmja garanci që dashuria jonë për Hyjin të mos jetë farsë.⁴⁴

(83) Për të nxitur këtë ndërgjegje për “të tjerët”, edukimi injacian **nenvizon vlerat vetjake të të jetuarit në bashkësi**: njëfarë barazie në mundësitë për të gjithë, parimet përndarëse të drejtësisë sociale, një qëndrim shpirtëror që sheh në shërbimin ndaj të tjerëve, realizimin e plotë të vetvetes po ashtu si ai që arrihet përmes suksesit apo mirëqënies ekonomike.⁴⁵

(84) Të rriturit e bashkësisë edukative, veçanërisht ata që janë çdo ditë në kontakt me studentët, **shfaqin me jetën e tyre** këtë përkujdesje për të tjerët si dhe vlerat që i japin dinjitetit njerëzor.⁴⁶

5.4. VEMENDJE TE VEÇANTE PER TE VARFERIT.

(85) Duke reflektuar mbi gjendjen reale të botës sot, për t'iu përgjigjur thirrjes së Krishtit që ka përjetuar një

dashuri e vëmendje të veçantë për të varfërit, Kisha dhe Shoqëria e Jezusit kanë bërë një “zgjedhje parapëlqyese”⁴⁷ për të varfërit. Kemi parasysh ata që nuk kanë mjete ekonomike, handikapatët, të braktisurit dhe të gjithë ata që, në njëfarë mënyre, nuk mund të gëzojnë një jetesë plotësisht të respektueshme për dinjitetin e njeriut. Në shkollat e jezuitëve kjo zgjedhje pasqyrohet në kriteret e pranimit të studentëve dhe në formimin që u jepet atyre.

(86) Shkollat e jezuitëve nuk janë të rezervuara për një kategori të veçantë studentësh;⁴⁸ Shën Injaci pranonte të ngrinte kolegje vetëm atëherë kur për ato ishte ofruar një mbështetje e plotë ekonomike, në mënyrë që edukimi të ishte i hapur për të gjithë; ai ngulmonte që në çdo formacion të kishte lehtësi të veçanta për të pritur të varfërit dhe që mësuesit të tregonin vëmendje të veçantë për nevojat e studentëve me kushte të rënda ekonomike. Sot, megjithëse kushtet ndryshojnë dukshëm nga një shtet në tjetrin dhe kriteret i veçantë të pranimit të studentëve varen nga “rrethanat e vendit dhe të njerëzve”, çdo shkollë e jezuitëve bën ç'është e mundur me qëllim që kurset e saj të jenë të **hapura për të gjithë**, duke përfshirë të varfërit dhe ata që ndodhen në kushte të pafavorshme.⁴⁹ Ndihma ekonomike për të rinjtë nevojtarë dhe zbritja e pagesës për konvikt në masën e mundshme, janë mjetet për të arritur këtë objektiv. Përveç kësaj, shkollat e jezuitëve sigurojnë mbështetje në planin shkollor dhe në atë të orientimit për të gjithë ata që kanë nevojë, në mënyrë që të gjithë të përfitojnë nga edukimi që u ofrohet.

(87) Për t'u dhënë mundësi prindërve, veçanërisht atyre të shtresave më të varfëra, të zgjedhin lirisht edukimin të fëmijëve të tyre, shkollat e jezuitëve marrin

pjesë në lëvizjet që nxisin realizimin e mundësive për një edukim falas për të gjithë. “Rivendikimi i mundësisë së barabartë në fushën e edukimit dhe liria e arsimimit bëjnë pjesë në përpjekjet e pareshtura tona për nxitjen e drejtësisë”⁵⁰

(88) Veçoritë e formimit të dhënë kualifikojnë shkollën më shumë se sa tipi i studentëve të pranuar. Në edukimin injacian, bashkësia shkollore përçon ato vlera që nxisin vëmendjen e veçantë të burrave dhe të grave që nuk disponojnë mjetet e nevojshme për të bërë një jetë dinjitoze njerëzore. Këto janë vlerat e dëshmuara dhe të vëna në praktikë në zgjedhjet themelore të shkollës, në strukturat e saj, në atmosferën që krijon ajo. Është pikërisht në këtë kuptim që të **varfërit përbëjnë kontekstin** e institucionit edukativ injacian: “Projekti ynë edukativ duhet të ndërtohet në funksion të të varfërve, nga pikëpamja e të varfërve”.⁵¹

(89) Studentëve u ofrohen **mundësi takimi me botën e varfërisë dhe raste për t`u shërbyer të varfërve**, si brenda shkollës, ashtu dhe në projekte jashtë saj; studentët do të mësojnë të duan çdo njeri si vëlla ose motër brenda bashkësisë njerëzore dhe gradualisht do të arrijnë të njohin përherë dhe më mirë shkaqet e varfërisë.

(90) Që ky **kontakt** të rezultojë edukativ, atij duhet t`i bashkohet një reflektim i përshtatshëm. Nxitja e drejtësisë në curriculumin e jetës shkollore, përkthyer më sipër tek numri 80, parashikon si objektiv konkret një analizë të shkaqeve të varfërisë.

(91) **6. Për Shën Injacin, përgjigja ndaj thirrjes së Krishtit nuk mund të ketë vend tjetër përveçse brenda dhe nëpërmjet Kishës Katolike, mjeti përmes të cilit Krishti me anë të sakramendeve është i pranishëm në botë. Maria, Nëna e Krishtit, është modeli i kësaj përgjigjeje. Shën Injaci dhe dishepujt e tij të parë ishin që të gjithë meshtarë dhe deshën të vinin Shoqërinë e Jezusit në shërbim të Vikarit të Krishtit, “për t`i dërguar në çdo pjesë të botës ku ai do ta gjykonte të nevojshme për lumninë e Hyjit dhe për të mirën më të madhe të shpirtave”.**⁵²

(92) Edukimi injacian - është një mjet apostolik në shërbim të Kishës që zhvillon misionin e saj në shërbim të njerëzve.
- përgatit studentët për të marrë pjesë në mënyrë

aktive në jetën e Kishës dhe të bashkësisë vendëse, në shërbim të të afërmit.

6.1. NJE MJET APOSTOLIK NE SHERBIM TE KISHES.

(93) Shkollat e jezuitëve përfshihen në **misionin apostolik të Kishës** për ndërtimin e Mbretërisë së Hyjit. Edhe pse që nga koha e Shën Injacionit metodat e edukimit kanë ndryshuar thellësisht si dhe mënyra e paraqitjes së përmbajtjes së fesë është e ndryshme, edukimi injacion mbetet ende një mjet i vlefshëm për të ndihmuar studentët në drejtim të një njohjeje më të mirë të Hyjit dhe të një përgjigjeje bujare thirrjes së tij. Shkolla mbetet një mjet i rëndësishëm për t'iu përgjigjur kërkesave të sotme të popullit të Hyjit. Qëllimi i edukimit injacion është formimi i njerëzve të frymëzuar nga parime të drejta, të orientuara drejt vlerave të vërteta, i njerëzve për të tjerët sipas modelit të Krishtit. Prandaj mësimdhënia në një shkollë të jezuitëve është një minister eklezjal.

(94) Një shkollë e Shoqërisë përçon në të gjithë bashkësinë qëndrimin injacion të **sinqeritetit dhe të shërbimit ndaj Kishës**, popullit të Hyjit, që është një karakteristikë e të gjitha veprimtarive të Shoqërisë. Ata që i përkasin besimeve të tjera, mund të realizojnë idealet dhe dëshirat e tyre në harmoni me qëllimet e Shoqërisë;

ata mund t'i kushtohen zhvillimit integral të studentëve dhe përmirësimit të shoqërisë.

(95) Edukimi injacion duke respektuar ndërgjegjen dhe bindjet e çdo studenti, është **besnik i mësimave të Kishës**, veçanërisht për sa i përket formimit moral dhe fetar. Për sa ka mundësi, shkolla zgjedh si drejtues të kualifikuar të bashkësisë edukative njerëz që janë në gjendje të mësojnë dhe të dëshmojnë mësimet e Krishtit të parashtruara nga Kisha katolike.

(96) Bashkësia edukative, duke u bazuar në shembullin e Krishtit – dhe mbi atë të Marisë në përgjigjen e saj ndaj Krishtit⁵³ dhe duke **reflektuar mbi kulturën e sotme** në dritën e mësimave të Kishës, nxit:⁵⁴

- një vizion shpirtëror të botës kundrejt materializmit;
- një gatishmëri për të tjerët kundrejt egoizmit;
- thjeshtësinë kundrejt konsumizmit;
- çështjen e të varfërve kundrejt padrejtësisë sociale.

(97) Si pjesëmarrje në shërbim të Kishës, një shkollë e Shoqërisë **vihet në shërbim të bashkësisë vendëse, civile dhe fetare, në bashkëpunim me ipeshkvin e vendit**. Për shembull vendime të rëndësishme që kanë të bëjnë me zgjedhjet kryesore të shkollës mbajnë parasysh orientimet baritore të kishës vendëse; përpara marrjes së këtyre vendimeve duhet të peshojmë efektet e mundshme mbi kishën dhe mbi bashkësinë vendëse.

(98) Për t'iu përgjigjur nevojave të njerëzve me një shërbim sa më efikas, një shkollë e jezuitëve punon në **bashkëpunim me veprimtaritë e tjera apostolike** të jezuitëve, me famullitë e vendit dhe institutet e tjera

katolike dhe civile dhe me qendrat e apostullimit shoqëror.

(99) Pjesëtarët e bashkësisë edukative zhvillojnë një **shërbim** aktiv në **Kishë e në bashkësinë vendëse**. Ata marrin pjesë në mbledhjet dhe veprimtari të tjera, veçanërisht në ato që trajtojnë problemet e edukimit.

(100) Në një shkollë të Shoqërisë nxitet **bashkëpunimi në veprimtari të ekumenike** dhe pjesëmarrja aktive në dialogun me të gjithë burrat dhe gratë vullnetmirë: bashkësia edukative bëhet dëshmitare e Ungjillit të Krishtit në shërbim të bashkësisë njerëzore.

6.2 PERGATIT PER NJE PJESEMARRJE AKTIVE BRENDA KISHES.

(101) Edukimi injacian angazhohet për arritjen e pjekurisë fetare të të gjithë studentëve. Ata **do të marrin një instruktim të përshtatshëm mbi të vërtetat themelore të fesë së tyre**. Për të krishterët një gjë e tillë nënkupton njohjen e Shkrimeve të Shenjta dhe veçanërisht të Ungjijve.

(102) Për studentët katolikë shkolla nxit **njohjen dhe dashurinë për Kishën dhe Sakramendet**, raste këto të privileguara për takimin me Krishtin.

(103) Me mënyrat që janë të saj, shkolla u ofron të gjithë studentëve **përvojën konkrete të jetës kishtarë**,

nxit pjesëmarrjen në projektet dhe në veprimtari të kishës. Profesorët laikë, veçanërisht ata më aktivët në bashkësitë famullitare, mund të marrin nismën e nxitjes së këtyre përvojave; do të jenë ata që do të përçojnë tek studentët orientimet e sotme të apostullimit të laikëve.

(104) Në shkollat e vjetra të Shoqërisë, Kongregacionet Mariane luajtën një rol shumë të madh në përtëritjen e jetës shpirtërore dhe në angazhimin kristian. Sot duhet t'u propozojmë studentëve dhe të rriturve që dëshirojnë të njohin më në thellësi Krishtin dhe të modelojnë jetën e tyre në të tijën, **Bashkësitë e Jetës Kristiane** apo bashkësi të barasvlefshme. Shkolla do të ndihmojë edhe pjesëtarët e besimeve të tjera të thellojnë angazhimin e tyre fetar.

(105) **7. Shën Injaci ka këmbëngulur vazhdimisht mbi “magis” – për më “shumë”. Tensioni i tij i qëndrueshëm ka qenë për një shërbim me vlera me të mëdha ndaj Hyjit, i realizuar me një ndjekje gjithnjë e më besnike, gjithnjë e më të madhe tek Krishti. I njëjta gatishmëri ka gjallëruar veprën apostolike të dishepujve të parë. Përgjigja konkrete ndaj dashurisë së Hyjit duhet të jetë e “një vlere më të madhe”.**⁵⁵

(106) Edukimi injacian - kërkon të shkëlqyerit në punën e formimit.
- jep dëshmi të të shkëlqyerit.

7.1. TE SHKELQYERIT I NDJEKUR NE FORMIM.

(107) Në edukimin injacian kriteri i të shkëlqyerit zbatohet në të gjitha mjediset e jetës së shkollës. Qëllimi që i kemi vënë vetes është zhvillimi sa më i plotë i të

gjitha përmasave të njeriut, së bashku me një rritje sa më të madhe të vlerave dhe të angazhimit për një shërbim, që privilegjon të varfërit dhe është i gatshëm të sakrifikojë interesat e veta për nxitjen e drejtësisë.⁵⁶ Kërkimi i të shkëlqyerit në planin shkollor është normal në një shkollë të Shoqërisë, por vetëm në kontekstin më të gjerë të një të shkëlqyeri të vërtetë njerëzor.⁵⁷

(108) Të shkëlqyerit, me të gjitha kriteret e tjera injaciane, përcaktohet në funksion të “rrethanave të vendit dhe të njerëzve”. “Tipi i institucionit, vendndodhja e tij, përmasat e shkollës, përcaktimi i objektivave lidhur me cilësinë e edukimit ose të tipit të nxënësve të cilëve u drejtohet ai, etj., janë elementë, që ndryshojnë mjetin për ta përshtatur sipas rrethanave në të cilin përdoret.”⁵⁸ Kërkimi i “magis” qëndron pikërisht në sigurimin e tipit dhe të nivelit të mësimdhënies që më mirë i përgjigjen nevojave të vendit në të cilin ndodhet shkolla, në lidhje me tipin e nivelin e moshës së nxënësve.

(109) “Magis” nuk nënkupton krahasimin me të tjerët, as që zhvillimet të maten sipas një standarti të përcaktuar; kemi të bëjmë më tepër me **zhvillimin në mënyrë sa më të plotë që të jetë e mundur** dhe, në çdo periudhë të jetës, **të aftësive që natyra i ka fal çdo njeriu; kemi të bëjmë me rritjen mbi bazën e atyre motiveve, që i japin shkas zhvillimit të talenteve të çdonjërit për t’i vënë në shërbim të tjerëve.**

(110) Një nga pikëpamjet tradicionale të edukimit të jezuitëve ka qenë formimi i “leaders”: burra dhe gra që, duke marrë mbi vete përgjegjësi në shoqëri, kanë

mundësi të influencojnë pozitivisht në marrëdhënie me të tjerët. Ky objektivi ka sjellë në disa raste teprime që duhen korrigjuar. Çfarëdo që të ketë qenë në të kaluarën interpretimi i këtij qëllimi edukativ, pikësynimi i instituteve të jezuitëve, konform kuptimit aktual të vizionit injacian mbi botën, nuk është ai i përgatitjes së një elite socio-ekonomike, por kryesisht edukimi i **leader në shërbimin ndaj të tjerëve**. Prandaj shkollat e Shoqërisë, do të ndihmojnë studentët në zhvillimin e atyre cilësive mendore dhe ndjesore që do t'i bëjnë të aftë, pavarësisht nga posti që ata do të kenë në jetë, të punojnë me të tjerët për të mirën e të gjithëve, në shërbim të Mbretërisë së Hyjit.

(111) Ky vullnet për të shërbyer i ka rrënjët në një **besim angazhues** dhe të jetuar që për të krishterët shndërrohet në ndjekje të Krishtit. Vendimi për të ndjekur Krishtin, i marrë në dashuri, nxit dëshirën për të bërë gjithnjë “më shumë” dhe na bën “shumëfishues” të vërtetë.⁵⁹ Kjo dëshirë, nga ana e vet, vë në lëvizje studentin për të realizuar përgatitjen e vet me angazhimin bujar në studim, në formimin vetjak dhe së fundi në veprim.

(112) “Ratio Studiorum” këshillon **aftësinë konkurruese** – normalisht midis grupeve se sa midis personave të veçantë – si një stimul efikas për zhvillimin shkollor. Sot edukatorët gjinden përballë një realiteti të ndryshëm: një botë në të cilën shpirti i tepërt konkurrues ka çuar në individualizëm, në konsumizëm dhe në suksesin e arritur me çdo kusht. Megjithatë nuk mohan efektin stimilues të lojrave të shëndosha konkurruese, një shkollë moderne e jezuitëve i shtyn studentët të dallohen

më mirë në aftësinë për të punuar së bashku, për të qenë të kujdesshëm njëri për tjetrin, të angazhohen në shërbim të tjerëve, i jetuar në ndihmën reciproke. “Një dëshirë e vërtetë e dëshmisë kristiane ... nuk mund të zhvillohet në një atmosferë konkurruese shkollore, ose në një mjedis në të cilin cilësitë vetjake vlerësohen vetëm duke i krahasuar me ato të tjerëve. Më mirë zhvillohet në një mjedis në të cilin ushtrohem për të qenë të gatshëm e të gjindshëm”.⁶⁰

7.2. TE JAPESH DESHMI TE TE SHKELQYERIT.

(113) **Përparësitë kryesore të shkollës** duhet të jenë të tilla që të krijojnë një mjedis dhe një “klimë” që nxit të shkëlqyerit e vërtetë. Kjo politikë nënkupton një qëndrim vlerësues të përhershëm të pikësynimeve të shkollës, të programeve të saj, të veprimtarive dhe të metodave të mësimdhënies, në përpjekjet për të bërë çdo veprimtari edukative përherë dhe më efikase në drejtim të arritjes së qëllimeve të saj.

(114) Të **rriturit** e bashkësisë shkollore japin dëshmi në kërkim të “magis” me rritjen e tyre në kompetencat profesionale dhe në dhurimin e vetvetes.

(115) Profesorët dhe drejtuesit bashkëpunojnë me shkollat e tjera dhe institutet edukative për të individualizuar atë që rezulton më e vlefshme për politikën e përgjithshme të shkollës, në proceset edukative dhe në metodat pedagogjike.⁶¹

(116) **8. Kur Shën Injaci bëri përvojën e dashurisë ndaj Hyjit, zbuluar në Krishtin, e filloi t'i përgjigjet me dhurimin e vet shërbimit të Mbretërisë së Hyjit, ai vendosi ta ndajë këtë përvojë dhe mblodhi rreth vetes disa dishepuj që u bënë "miqtë e Hyjit",⁶² në shërbim të të tjerëve. Forca e një bashkësie, që vihet në shërbim të Mbretërisë është më e madhe se ajo e një njeriu të vetëm apo e një grupi njerëzish.**

<p>(117) Edukimi injacian</p>	<ul style="list-style-type: none"> - nënvizon bashkëpunimin midis jezuitëve dhe laikëve. - mbështetet në shpirtin e bashkësisë, që bashkon: <ul style="list-style-type: none"> mësuesit dhe drejtuesit; bashkësinë e jezuitëve; këshillat eshkollës; prindërit; studentët; ish-studentët; bamirësit; - është i strukturuar në atë mënyrë që të nxitë shpirtin e bashkësisë.
-------------------------------	--

8.1. BASHKEPUNIM MIDIS LAIKEVE DHE JEZUITEVE.

(118) Bashkëpunimi midis jezuitëve dhe laikëve është një objektiv i qartë që një shkollë e Shoqërisë përpigjet ta realizojë në përgjigje të kërkesave të dala nga Konkili II i Vatikanit⁶³ dhe Kongregacionet e fundit të Përgjithshme të Shoqërisë së Jezuitëve.⁶⁴ Meqë koncepti i një **misioni të përbashkët** është relativisht i ri, nevojitet një përpjekje e mëtejshme për një kuptim dhe një planifikim më të kujdesshëm të tij.

(119) Në një shkollë të Shoqërisë laikët dhe jezuitët janë të gatshëm të ushtrojnë përgjegjësitë e ndryshme dhe të punojnë bashkërisht jo vetëm si udhëheqës por edhe në role të tjera. Përpigjen të arrijnë një bashkim të vërtetë shpirtëror dhe të punojnë së bashku si një trup i vetëm apostolik⁶⁵ për formimin e studentëve. Të gjithë përpigjen të kenë të njëjtin vizion të realitetit, të aspiratave dhe të angazhimit të tyre apostolik.

(120) Struktura juridike e shkollës lejon bashkëpunimin e mundshëm më të gjerë në drejtimin e instituteve.⁶⁶

(121) Jezuitët nxisin aktivisht bashkëpunimin me laikët në shkollë. "Ta kuptojnë mirë jezuitët çfarë rëndësie ka për Shoqërinë ky bashkëveprim me laikët. Ata kanë për të qenë gjithnjë për ne interpretuesit e natyrshëm të botës sonë sot dhe në këtë mënyrë do të na japin vazhdimisht një ndihmë të çmuar për këtë apostullim".⁶⁷ "Ne duhet të jemi të gatshëm të bashkëpunojmë me të tjerët ... të gatshëm për të luajtur një rol dytësor, mbështetës, anonim; të gatshëm për të mësuar prej atyre që përpigemi t'u shërbejmë".⁶⁸ Një ndër përgjegjësitë e eprorit fetar

është pikërisht mbështetja e këtij qëndrimi në punën apostolike.

8.2. MESUESIT DHE DREJTUESIT.

(122) Për aq sa ka mundësi, ata që do të thirren të punojnë në bashkësinë edukative të një shkolle të mbajtur nga jezuitët, duhet të jenë burra dhe gra **të aftë për të depërtuar në vetë natyrën dalluese të saj, për të realizuar karakteristikat që përcaktojnë vizionin injacian.**

(123) Për të nxitur këtë **ndjenjë të përbashkët për qëllimet që kërkohet të praktikohen në rrethanat konkrete të jetës shkollore**, drejtuesit, personeli mësimor dhe jomësimor, jezuitët dhe laikët, komunikojnë rregullisht midis tyre në planin vetjak, profesional dhe fetar. Ata janë gati të ndajnë së bashku vizionin e botës dhe shpresat, dëshirat dhe përvojat, arritjet dhe mosarritjet.

8.3. BASHKESIA E JEZUITEVE.

(124) Jezuitët që punojnë në shkollë: “duhet të paraqiten si një grup njerëzish me identitet të qartë, që jetojnë me të njëjtën dhunti injaciane, të lidhur ngusht, ‘ad intra’, nga bashkimi dhe dashuria e ndërsjelltë, dhe ‘ad extra’ nga pjesëmarrja plot gëzim në një mision të përbashkët ... Bashkësia fetare duhet të shërbejë si frymëzim dhe stimul për përbërësit e tjerë të bashkësisë edukative ... **Dëshmia e jetës sonë është themelore**”.⁶⁹

(125) Bashkësia e jezuitëve do të jetë në gjendje të shërbejë dhe të frymëzojë me efektshmëri të gjithë bashkësinë edukative nëse përbërësit janë tashmë, njëri për tjetrin, **të aftë për shërbim dhe burim frymëzimi të ndërsjelltë** dhe formojnë një bashkësi të vërtetë lutjesh dhe jete. Kjo dëshmi e jetuar është një nga mjetet për të përballuar punën në shkollë si një apostullim të të gjithë ‘trupës’ së jezuitëve dhe do të ndihmojë të gjithë bashkësinë e shkollës për të qenë efektivisht më të bashkuar.

(126) Së paku në raste të veçanta, disa prej anëtarëve të bashkësisë edukative ftohen për bukë, në celebrimet liturgjike ose në ngjarje të tjera sociale të bashkësisë së jezuitëve. Kalimi së bashku i kohës në mënyrë formative është një mjet i favorshëm për të ndërtuar bashkësinë, dhe laikët kanë mundësi të kuptojnë më mirë jetën e jezuitëve nëse atyre u jepet mundësia për të marrë pjesë në to.

(127) Përveç përgjegjësive të tyre profesionale në shkollë si mësues, drejtues, ose gjallërues të veprimtarisë baritore, jezuitët janë të gatshëm për veprimtari të tilla si **diskutime, takime reflektimesh të përbashkëta dhe ushtrimesh shpirtërore ditore**, që u japin mundësi pjesëtarëve të tjerë të bashkësisë edukative të njohin më mirë dhe të stimojnë vizionin e botës së Shën Injacit.

(128) Puna edukative, – si ajo e drejtuesve ashtu dhe ajo e personelit mësimor dhe jomësimor, – është në vetvete apostolike. Sipas kësaj karakteristike që e bën shkollën mjet apostolik për misionin e Kishës, meshtarët jezuitë do të bëjnë një punë më të drejtpërdrejtë meshtarake me

celebrimin e Eukaristisë, duke i vënë në gatishmëri për Sakramendin e Ripajtimit, etj.

(129) Statutet e çdo institucioni përcaktojnë përgjegjësitë e Drejtorit të Veprës dhe autoritetin që ushtron në të Shoqëria e Jezusit (Shih 8.9). Duke patur parasysh rrethanat vendëse, asnjë nga jezuitët, as edhe bashkësia e jezuitëve si e tillë, nuk ka ndonjë pushtet vendimor në një shkollë të Shoqërisë që të jetë e ndryshme nga ajo e përshkruar në statutet.

8.4. KESHILLAT E SHKOLLES.

(130) Kongregacioni i XXXI i Përgjithshëm i Shoqërisë ka porositur që në çdo shkollë të ngrihen Këshillat e shkollës që të përfshijnë si laikët ashtu dhe jezuitët.⁷⁰ Edhe ky është një mjet i rëndësishëm i shpërndarjes së përgjegjësisë midis jezuitëve dhe laikëve dhe, si i tillë, nxitës i bashkëpunimit të tyre. Këshilli pasurohet kështu nga kompetencat e ndryshme profesionale të njerëzve që e përbëjnë. Komponentët e këtyre këshillave, jezuitë e laikë, njohin në thellësi objektivat e shkollave të Shoqërisë dhe vizionin e Shën Injacionit nga i cili ato rrjedhin.

8.5. PRINDERIT.

(131) Mësuesit dhe drejtuesit **bashkëpunojnë ngusht me prindërit**, edhe ato gjymtyrë të bashkësisë edukative. Midis shkollës dhe familjes zhvillohet një dialog i hapët dhe një komunikim i shpeshtë. Prindërit janë të informuar për veprimtaritë e shkollës dhe nxiten për të

takuar mësuesit me qëllim që të diskutojnë me ta përparimin e fëmijëve të tyre. Prindërve u jepet mbështetje morale lidhur me ndërgjegjësimin e tyre për rolin që duhet të luajnë ata në këtë mes si dhe mundësinë që ata të marrin pjesë në organet e përshtatshme kolegjiale. Me këto dhe mënyra të tjera prindërit ndihmohen për t'u bërë ballë përgjegjësisë të tyre si edukatorë në shtëpi dhe në familje dhe, nga ana e tyre, të ndihmojnë në punën që zhvillohet në shkollë.⁷¹

(132) Për aq sa ka mundësi, prindërit **kuptojnë, çmojnë dhe pranojnë vizionin injacion mbi botën**, që karakterizon shkollat e Shoqërisë. Bashkësia shkollore, duke patur parasysh rrethanat konkrete të vendeve të ndryshme, krijon premisat e duhura me anë të të cilave prindërit familjarizohen përherë dhe më shumë me këtë vizion të botës dhe me aplikimet e tij në fushën e edukimit.

(133) **Duhet të favorizojmë koherencën midis vlerave që mundëson shkolla dhe atyre që merren në familje.** Kur regjistrojnë për herë të parë fëmijët në shkollë, prindërit informohen për angazhimin e Shoqërisë në edukimin e një besimi të aftë për nxitjen e drejtësisë. Prindërve u jepen programet e formimit të përhershëm që t'u krijojnë atyre mundësinë të kuptojnë gjithnjë e më mirë qëllimet e Shoqërisë dhe në këtë mënyrë të japin edhe ata kontributin e tyre vetjak në arritjen e këtyre qëllimeve.

8.6. STUDENTET.

(134) Studentët formojnë një bashkësi mbështetur në **kuptimin dhe ndihmën reciproke**. Një gjë e tillë bëhet në mënyrë formative, por edhe përmes zgjedhjes së përfaqësuesve të studentëve dhe formimit të këshillave të tyre. Për më tepër, në varësi me moshën dhe pjekurinë e tyre, pjesëmarrja e studentëve në jetën e shkollës nxitet me anë të pranisë së tyre në organet kolegjiale dhe në komitete të tjera të ngjashme.

8.7. ISH-NXENESIT.

(135) Ish-nxënësit bëjnë pjesë në “bashkësinë e atyre që veprojnë në shërbim të Mbretërisë”: një shkollë e Shoqërisë ka për ata një përgjegjësi të veçantë. Brenda mundësive, shkolla u jep atyre këshilla dhe formim të përhershëm në mënyrë që ata që kanë marrë formimin bazë në këtë shkollë, të kenë mundësi të bëhen gjithnjë e më shumë të aftë ta praktikojnë atë në moshën e rritur dhe të vazhdojnë punën intensive në shërbim të tjerëve.⁷² **Midis shkollave të jezuitëve dhe shoqatave të ish-nxënësve** ekzistojnë lidhje të ngushta miqësie dhe ndihme reciproke.⁷³

8.8. BAMIRESIT.

(136) Në mënyrë të ngjashme, një shkollë e Shoqërisë ka përgjegjësi të veçantë për bamirësit e saj dhe u jep atyre ndihmën dhe këshillat që ata kanë nevojë. Në veçanti, bamirësve u krijohet mundësia të njohin më mirë natyrën specifike dhe objektivat e shkollave të Shoqërisë, që ato ndihmojnë, si dhe vizionin injacian që ndodhet në bazën e tyre.

8.9. STRUKTURAT E SHKOLLES.

(137) Gjatë viteve të fundit është përhapur gjithnjë dhe më shumë praktika e **ndarjes së përgjegjësive**. Vendimet tashmë merren vetëm pasi të jenë verifikuar mendimet e ndryshme në konsultime formative, në mbledhjet e këshillave të veçanta dhe forma të tjera të ngjashme. E gjithë bashkësia edukative informohet rregullisht për vendimet dhe ngjarjet më të rëndësishme të jetës në shkollë. Që të jetë me të vërtetë efikase kjo ndarje e përgjegjësive, ajo duhet të bazohet në **vizionin e përbashkët** të realitetit dhe të objektivave të shkollës për të cilat është folur më sipër.

(138) Në të kaluarën Rektori i bashkësisë së jezuitëve, i emëruar nga Eprori i Përgjithshëm i Shoqërisë së Jezusit, kishte përgjegjësinë e drejtimit të shkollës. Ai i jepte rregullisht llogari Provincialit të Shoqërisë. Sot, në shumë vende të botës, Rektori i bashkësisë nuk është më “Drejtori i Veprës”. Në disa raste, ky drejtor që gjithnjë e më shpesh është një laik, emërohet nga Këshilli Administrativ, që bashkëpunon me Shoqërinë. Çfarëdo qofshin situatat e veçanta dhe mënyrat e emërimit, përgjegjësia që i besohet drejtorit të një instituti jezuit, gjithnjë nënkupton **një mision që, në analizën e fundit, rrjedh nga Shoqëria e Jezusit**. Ky mision, në masën që i referohet karakteristikave të edukimit injacian, i nënshtrohet verifikimit periodik nga ana e Shoqërisë (normalisht përmes Atit Provincial të jezuitëve apo një të deleguarit të tij).

(139) **Detyra e drejtorit** është ajo e një udhëheqësit të një veprë apostolike. Ky rol jetësor realizohet duke frymëzuar, duke zhvilluar vizionin e përbashkët të realitetit dhe në sigurimin e unitetit të bashkësisë edukative. Meqë baza e horizontit të përbashkët ndërtohet mbi vizionin injacian të botës, drejtuesi i veprës apostolike, përveç faktit se udhëhiqet nga ky vizion, përkujdeset që e gjithë bashkësia edukative të përparojë në një kuptim më me shumë vlera e të qëniti injacian dhe e aplikimit të tij në edukim. Përveç këtij roli frymëzues, drejtori mbetet **përgjegjësi kryesor i ekzekutimit të politikës themelore edukative të shkollës dhe i karakteristikave të veçanta të edukimit injacian.** Aspektet e sakta të kësaj përgjegjësie janë të përcaktuara në statutet e çdo shkolle të veçantë.

(140) Në shumë raste përgjegjësia e shkollës ndahet midis njerëzve të ndryshëm që mbulojnë role të veçanta në mjediset e saj (Rektori, Drejtori dhe përgjegjës të tjerë). Përgjegjësia e fundit e politikës edukative dhe e praktikave shkollore shpeshherë u besohet këshillave drejtuese. Të gjithë ata që ndajnë përgjegjësitë bëjnë pjesë në **Këshillin Drejtues**. Të mbështetur në vizionin injacian të botës dhe në aplikimin e tij në edukim, ata bashkëpunojnë njëri me tjetrin të shtyrë nga një ndjenjë respekti e ndërsjelltë, që i krijon secilit prej tyre mundësinë për të shfaqur më mirë talentin e tij. Kjo strukturë pune me ekip që përbën aplikimin në praktikë të parimit të ndihmës reciproke, ka avantazhin e konvergimit të aftësive të shumë njerëzve në drejtimin e shkollës. Për më tepër, një gjë e tillë siguron një stabilitet më të madh në ndjekjen e një politike shkollore që realizon orientimet themelore të shkollës.

(141) Që shkolla të jetë e të quhet “e jezuitëve”, është e nevojshme që t’i mbesë Shoqërisë ai autoritet dhe ajo e drejtë vendimore që ta lejojë atë t’i përgjigjet, në institucionet e saj, thirrjeve të Kishës dhe të sigurojë që shkolla t’u mbesë besnike qëllimeve të saj. Me përjashtim të këtij kufizimi, çdo pjesëtar i bashkësisë edukative, jezuit apo laik, mund të ushtrojë veprimtarinë efektive në shkollë, me kusht që të njoh dhe të bëjë thellësisht të veten dhuntitë injaciane të edukimit dhe të punojë për realizimin e tyre.

(142) Strukturat e shkollës **sigurojnë të drejtat** e studentëve, të drejtuesve, të personelit mësimor dhe jomësimor, dhe **stimulojnë të gjithë në ushtrimin e përgjegjësive të tyre**. Të gjithë pjesëtarët e bashkësisë edukative punojnë së bashku për të krijuar dhe ruajtur kushtet më të favorshme me qëllim që secili të rritet në ushtrimin me përgjegjësi të lirisë së vet. Çdo pjesëtar i bashkësisë është i thirrur në **angazhimin aktiv** për rritjen e të gjithëve. Struktura shkollore i paraprin kështu asaj shoqërie të re që shkolla, nëpërmjet edukimit, kërkon të ndërtojë.

(143)

9. Shën Injaci dhe dishepujt e tij merrnin vendime përmes një procesi të vazhdueshëm “vlerësimi”⁷⁴ individual dhe të përbashkët, të zhvilluar përherë në një kontekst lutjesh. Një reflektim të ngjashëm, të shoqëruar me lutje, mbi rezultatet e veprimtarisë së tyre, udhëhiqte dishepujt edhe në rishikimin e metodave të shfrytëzuara prej tyre në kërkimin këmbëngulës për një shërbim “më me vlerë” (“magis”) ndaj Hyjit.

(144) Edukimi injacian

- përshtat mjetet dhe metodat në qëllimin për të arritur më mirë pikësynimet e veta.
- krijon një “sistem” shkollash të karakterizuara nga një vizion i përbashkët dhe nga objektiva të përbashkëta.
- ndihmon për t'i siguruar, veçanërisht mësuesve, raste të formimit të vazhdueshëm dhe të trajnimit profesional.

9.1. RISHIKIM DHE MODIFIKIM PER TE ARRITUR PIKESYNIMET E EDUKIMIT.

(145) Bashkësia edukative, në dritën e nevojave të shoqërisë së sotme, reflekton mbi vijën thelbësore të shkollës, mbi strukturat e saj, mbi metodat, pedagogjike dhe jo, aktualisht të përdorura dhe mbi të gjitha ata elementë, që ndikojnë në kontekstin shkollor, për të gjetur **mjetet që më mirë u përgjigjen pikësynimeve të shkollës** dhe vënë në jetë filozofinë edukative. Duke u nisur nga këto refleksione do të **bëhen ndryshimet** në strukturat, në metodat, në programet e shkollës, etj., kur kjo do të jetë e dobishme dhe e nevojshme. Një edukator, besnik ndaj traditave të Shoqërisë, nxitet të shfrytëzojë, mbi bazën e një zgjedhjeje të lirë, teknikat e mësimdhënies, metodat pedagogjike, etj. **Vijat udhëheqëse dhe praktika e shkollës nxisin këtë refleksion dhe verifikim** dhe bëjnë të mundur ndryshimet e nevojshme.

(146) Megjithëse çdo normë e përgjithshme duhet të aplikohet në rrethana konkrete, parimet mbi të cilat ndërtohet ky reflektim i vazhdueshëm ndodhen në dokumentet e sotme të Kishës dhe të Shoqërisë së Jezusit.⁷⁵ “Kushtetutat” e Shoqërisë, nga ana tjetër, na japin kriteret të ndryshme vlerësimi në drejtim të arritjes së “magis”: e mira më universale, nevoja më urgjente, vlera më e qëndrueshme, puna e pabërë nga të tjerët, etj.⁷⁶

(147) “Rrethanat e njerëzve dhe të vendeve” kërkojnë që programet e studimeve, pedagogjia, stili i mësimdhënies dhe krejt jeta e shkollës **të përshtaten për**

t'u përgjigjur nevojave specifike të vendit në të cilin ndodhet shkolla dhe e atyre që ajo don t'u shërbejë.

9.2. "SISTEMI" I SHKOLLAVE TE JEZUITEVE.

(148) Në shkollat e para të Shoqërisë, jezuitët vinin në bashkësi idetë dhe frutet e përvijës së tyre, në kërkim të parimeve dhe të metodave që të ishin më efikase për realizimin e qëllimit të veprës së tyre edukative. Çdo institucion aplikonte pastaj këto parime dhe metoda sipas situatës së vet; forca e sistemit të shkollave të Shoqërisë buronte pikërisht nga kjo nëndarje. Ende sot shkollat tona përbëjnë një sistem organik institucionesh, të pavarur në administrim dhe në përcaktimin e programeve, por të bashkuar nga **vizioni i përbashkët e nga të njëjtat pikësynime**; drejtuesit dhe mësuesit e shkollave të Shoqërisë kanë rimarrë këtë **shkëmbim idesh dhe përvijash** për të siguruar një realizim më të mirë të idealeve të përbashkëta.

(149) Ky shkëmbim idesh do të jetë më efikas nëse çdo shkollë është **e futur në realitetin konkret** të vendit në të cilin ndodhet dhe angazhohet në **shkëmbimin e vazhdueshëm të ideve dhe të përvijave me shkollat e tjera** dhe vepra të tjera edukative të kishës lokale dhe të vendit. Sa më të gjëra do të jenë shkëmbimet në nivel krahinor, aq më të frytshme do të jenë edhe ato midis shkollave të Shoqërisë në nivel ndërkombëtar.

(150) Për të nxitur gjithnjë e më shumë këtë shkëmbim idesh dhe përvijash, nxitet, aty ku është i mundur, **shkëmbimi i mësuesve dhe i studentëve**.

(151) Në të gjitha pjesët e botës ndeshemi në një larmi të madhe përvijash me anën e të cilave vazhdohet kërkimi i mjeteve sa më efikase me qëllim që "feja që nxit drejtësinë" të bëhet një aspekt i punës edukative. Duke patur parasysh rëndësinë e këtij objekti, dhe vështirësinë për ta arritur, këto përvija duhet të vlerësohen dhe rezultatet të bëhen të njohura në mënyrë që elementet pozitive të përfshihen në orientimet, në praktikën dhe në jetën e përbashkët të çdo shkolle. Bashkëndarja në këtë sektor është veçanërisht e nevojshme, jo vetëm për institutet e veçanta, por edhe për të gjithë apostullimin edukativ.

9.3. TRAJNIM PROFESIONAL DHE FORMIM I VAZHUESHEM.

(152) Ndryshimet e shpejta janë tipike për kohën tonë. Për të mbetur efikas si edukator dhe për të "vlerësuar" përgjigjet më të plota ndaj thirrjes së Hyjit, të gjithë të rriturit e bashkësisë kanë nevojë të nxjerrin përfitime nga **seksionet e formimit dhe trajnimit të vazhdueshëm personal**, veçanërisht për sa i përket kompetencave profesionale, teknikave pedagogjike dhe formimit shpirtëror. Shkollat e Shoqërisë nxisin këtë formim të vazhdueshëm duke organizuar kurse për edukatorët e vet dhe duke lehtësuar, për aq sa është e mundur, edhe me ndihmë ekonomike, pjesëmarrjen e tyre në programe më të përqëndruara përsosmërie.

(153) Për të arritur një bashkëpunim të hapur dhe një nëndarje efikase të përgjegjësive, **laikët kanë nevojë të njohin përshpirtmërinë injaciane**, traditat edukative

dhe historinë e edukimit të Shoqërisë dhe jetën e jezuitëve. Nga ana e tyre jezuitët duhet të njohin përvojën e jetuar, vështirësitë dhe sfidat e thirrjes laikale, mënyrat me të cilat Shpirti i Hyjit vë sot në lëvizje laikatin dhe kontributet e vlefshme që laikët i japin misionit të Kishës dhe shkollave të Shoqërisë. Shkolla e jezuitëve përpunon programe speciale formimi për pjesëtarët e rinj të bashkësisë edukative dhe organizon takime që, ndërsa nxisin njohjen në rritje dhe ndërgjegjësimin e pikësynimeve të edukimit injacian, u mundëson vetë jezuitëve, nga ana tjetër, të mësojnë nga laikët e bashkësisë. Kur ka mundësi, hartohen programe specifike trajnimi profesional e shpirtëror për laikët, që përgatiten të marrin përgjegjësi drejtuese në shkollat e Shoqërisë.

10. Disa karakteristika të pedagogjisë së jezuitëve

(154) Shën Injaci këmbëngulte që shkollat e jezuitëve të përshtatnin metodat e Universitetit të Parisit (“modus Parisiensis”) sepse i konsideronte më efikase për të arritur objektivat e përcaktuara nga ai për këto shkolla. Këto metoda vlerësoheshin dhe përshtateshin nga edukatorët e Shoqërisë në pajtim me përvojën e tyre fetare të “Ushtrimeve Shpirtërore” dhe me praktikën edukative gjithnjë në rritje. Shumë nga këto parime dhe metoda janë akoma tipike për institutet e jezuitëve pasi ato rezultojnë ende efikase për realizimin e karakteristikave të përshkruara në seksionet e mësipërme të këtij dokumenti. Disa elementë të kësaj metodologjie, midis atyre më të njohurve, janë numëruar si shembull, në këtë seksion të fundit.

A. NGA PERVOJA E “USHTRIMEVE SHPIRTERORE”⁷⁷

(155) 1. Megjithëse ekzistojnë ndryshime të dukshme midis dy gjendjeve, **lloji** i marrëdhënies midis atij që jep “Ushtrimet Shpirtërore” dhe atij që i bën, përbën modelin e marrëdhënies midis mësuesve dhe studentëve. Në mënyrë të ngjashme me atë që jep “Ushtrimet”, mësuesi është në shërbim të studentëve, i vëmendshëm në individualizimin e talenteve të tyre vetjake, apo të vështirësive të tyre specifike, i përfshirë personalisht dhe i angazhuar në përkrahjen e zhvillimit të energjive të brendshme të çdo studenti.

(156) 2. Roli aktiv i atij që bën “Ushtrimet” jep modelin

për veprimtaritë e nxënësve në studim, në kërkimin dhe në ushtrimin e krijimtarisë vetjake.

(157) 3. Pasardhja e strukturuar dhe progresive e elementeve të “Ushtrimeve” është një nga burimet e atij qëndrimi të vetë pedagogjisë së jezuitëve, që në mënyrë praktike dhe të rregullt organizon “mjetet për t`ia arritur qëllimit”.⁷⁸

(158) 4. “Praesupponendum”⁷⁹ e “Ushtrimeve” është norma sipas së cilës realizohen marrëdhëniet personale dhe raportet e mira midis profesorëve dhe studentëve, midis mësuesve dhe drejtuesve, në brendësi të trupit mësimor, midis studentëve, dhe midis të gjithë pjesëtarëve të bashkësisë edukative.

(159) 5. Shumë nga “Shënimet”, “shënimet hyrëse për ata që japin ... ‘Ushtrimet’” përmbajnë nëse përshtaten si duhet, këshilla të vlefshme për mësuesit e një shkolle të Shoqërisë.

(160) 6. Disa metodologji të vetë “Ushtrimeve” kanë krijuar metoda të ngjashme mësimdhënieje tipike të jezuitëve, dhe janë përfshirë në “Ratio Studiorum”:

a. Nga “hyrjet” dhe “shënimet shpjeguese” të lutjeve lind sugjerimi për leximin paraprak të materialit që duhet të shpjegohet;

b. Nga “përsëritjet” e lutjeve lind bindja që në zotërimin e një argumenti arrihet përmes

përsëritjeve të shpeshta dhe të vëmendshme të përmbajtjes së leksioneve.

c. Nga “aplikimi i shqisave” (“dëgjimi” injacian) lind vënia e theksit mbi krijim-tarinë dhe imagjina-tën, mbi përvojën, mbi rëndësinë e motivimit, interesin dhe gëzimin në të kuptuarit.

B. DISA SHEMBUJ DIREKTIVASH TE NXJERRA NGA “KUSHTETUTAT” DHE NGA “RATIO STUDIORUM”: (shih shtesën 1 për një përshkrim më të gjerë të këtyre dy dokumentave).

(161) 1. Ecuria në mësim duhet të shfrytëzohet me kujdes: në zbatimin e orarit të përditshëm të veprimeve, në mënyrën me të cilën ndërtohen kurset duke u nisur nga lënda e studiuar në kurset e zhvilluara më përpara, në mënyrën me të cilën kurset e disiplinave të ndryshme lidhen njëri me tjetrin. Curriculumi duhet të ndërtohet në mënyrë të integruar: çdo kurs, i koordinuar me kujdes me të tjerët, ndihmon në arritjen e pikësnyimeve globale të edukimit.

(162) 2. Pedagogjia e jezuitëve përfshin analiza, përsëritje, reflektim aktiv dhe sintezë; paraqitja teorike e ideve nuk duhet të ndahet nga aplikimi i tyre në praktikë.

(163) 3. E rëndësishme në të vërtetë nuk është sasia e materialit të zhvilluar, por kryesisht formimi i qëndrueshëm, i thellë dhe thelbësor. (“Non multa sed multum”).

(164) Në hyrje kemi kujtuar një takim mbajtur në Romë më 1980, dhe fjalën që Atë Pedro Arrupe mbajti në përfundim të tij. Kjo ndërhyrje ishte botuar më pas me titullin : “Kolegjet tona: sot dhe nesër” dhe është cituar disa herë si në përshkrimin e këtyre karakteristikave po ashtu dhe në shënimet.

(165) Në fjalën e tij Atë Arrupe përshkruante objektivat e një shkolle të jezuitëve. Kemi të bëjmë, thonte ai, me një shërbim që synon formimin e

“**Njerëzve të rinj**, të transformuar nga mesazhi i Krishtit, vdekja e të cilit dhe ngjallja duhen dëshmuar me vetë jetën. Ata të cilët dalin nga kolegjet duhet të kenë fituar, në mënyrë proporcionale me moshën dhe pjekurinë e tyre, një formë jete që të jetë në vetvete shpallje e **dashurisë** së Krishtit, e **fesë** që vjen nga Ai dhe të çon tek Ai, dhe e **drejtësisë** që Ai ka shpallur”.⁸⁰

(166) Tani së fundi, Ati i Përgjithshëm i sotëm i Shoqërisë së Jezusit, Atë Peter-Hans Kolvenbach, ka shprehur të njëjtin mendim me fjalë shumë të ngjashme:

“Ideali ynë është një personalitet harmonik, intelektualisht kompetent, gjithnjë i hapur për një zhvillim të mëtejshëm, fetar, i aftë për të dashur dhe i dhënë pas realizimit të drejtësisë përmes një shërbimi bujar ndaj popullit të Hyjit”.⁸¹

(167) Qëllimi i veprimtarisë edukative të Shoqërisë së Jezusit nuk ka konsistuar asnjëherë thjesht në përfitimin e një sasive informacionesh dhe aftësish apo në përgatitjen për një profesion të ardhshëm, megjithëqë këto gjëra kanë rëndësinë e tyre dhe janë të nevojshme për

Përfundimi

formimin e leaderve të krishterë. Qëllimi i fundit i edukimit në shkollat emesme të Shoqërisë është më tepër zhvillimi i plotë i njeriut që çon në veprim – një veprim i mveshur nga shpirti dhe prania e Jezu Krishtit, Njeriu për të Tjerët.

(168) Komisioni Ndërkombëtar i Apostullimit të Edukimit të Shoqërisë ka kërkuar të përshkruajë karakteristikat e edukimit injacian për të ndihmuar shkollat e jezuitëve të arrijnë në mënyrë më efikase këtë objektiv. Materiali i mbledhur nuk është i ri dhe as i plotë; puna rinovuese nuk përfundon kurrë. Një përshkrim i karakteristikave të veprimtarisë edukative të Shoqërisë nuk mund të jetë kurrë i përkryer dhe as mund të paraqitet si përfundimtar. Por një kuptim përherë dhe më i madh i pasurisë së trashëguar nga shkollat tona, aplikimi i vizionit injacian në edukim, mund të krijojnë bazën për një hap rinovues për t'iu kushtuar kësaj pune dhe i një dëshire të rinovuar për të ndërmarrë punën e lodhshme që do ta bëjnë përherë e më efikase.

Shtesa I

INJACI, SHKOLLAT E PARA TE JEZUITEVE DHE RATIO STUDIORUM

A. Itinerari shpirtëror i Injacit të Loyolës: 1491-1540

(Ky tregim i jetës së Shën Injacit bazohet mbi një “Autobiografi”,⁸² diktuar një miku jezuit tre vjet para vdekjes së tij, nganjëherë i cituar si ‘Tregimi i Pelegrinit’. Në të Shën Injaci flet gjithnjë në vetën e tretë).

Nga Loyola në Montserrat

(169) Injaci ishte një i ri me prejardhje nga fisnikëria e ulët, lindur më 1491 në kështjellën e familjes në Loyolë, në provincat Baske, dhe i edukuar si kavalier në oborret e Spanjës. Në autobiografinë e tij ai i përmbledh njëzet e gjashtë vitet e para të jetës së tij në një shprehje të vetme: “Ai ishte njeri i shoqërisë, i dhënë pas kotësive. I pëlqente sidomos të ushtrohej në përdorimin e armëve, i tërhequr nga një dëshirë e pamasë të fitojë një nderim pa kuptim”.⁸³ Kjo dëshirë për famë e çoi Injacin në Pamplona, qytet në kufi, që mbrohej nga sulmet e francezëve, mbrojtja ishte pa shpresë; kur me 20 maj 1521 ai u godit nga një predhë topi që i këputi një këmbë dhe plagosi tjetrën rëndë, si Injaci ashtu dhe qyteti i Pamplonës ranë në duart e francezëve.

(170) Francezët u kujdesën për Injacin dhe e dërguan në Loyolë, ku ai kaloi një konvaleshencë të gjatë. Gjatë kësaj periudhe të një mosaktiviteti të detyruar, ai kërkonte libra për të lexuar, dhe për të kaluar mërzinë pranoi të vetmit që gjindeshin: “Jetët e Shenjtërve” dhe “Jeta e Krishtit”. Kur nuk lexonte kavalieri romantik ëndërronte, shpesh herë sikur imitonte trimëritë e Shën Françeskut e Shën Domenikut, herë tjera bëmat plot trimëri kavalereske në shërbim të “njëfarë zonje”.⁸⁴ Pas

njëfarë kohe ai kujtohet që “kishte megjithatë një ndryshim. Duke menduar mbi gjërat e botës provonte shumë kënaqësi, por kur nga lodhja i braktiste ndjente zbrazëti dhe zhgënjim; përkundrazi nëse mendonte ... të praktikonte të gjithë zakonet e thjeshta që i kishte njohur si të përhershme në shenjtërit, këto mendime jo vetëm e ngushëllonin ndërsa ndalonte pak, por dhe më pas pasi i braktiste e linin të kënaqur dhe plot gëzim ... derisa njëherë iu hapën pak sytë ... ; i mrekulluar nga ky ndryshim filloi të reflektojë. Pak nga pak mësoi të njohë larminë e shpirtrave që trazoheshin në Të”.⁸⁵ Injaci ishte duke zbuluar Hyjin në veprim në jetën e tij; dëshira e tij për famë shkonte duke u shndërruar në një dëshirë t'i kushtohej plotësisht Hyjit, edhe pse ai ishte ende i pasigurtë mbi kuptimin e kësaj dëshire. “Gjëja që para të gjithave i shkonte në mendje ishte që porsa të shërohej të shkonte në Jeruzalem ... duke iu imponuar atyre trimërive dhe krezhmëve të mëdha, nga të cilat gjithnjë frymëzohet një shpirt bujar dhe i dashuruar në Hyjin”.⁸⁶

(171) Sapo u shërua plotësisht, Injaci nisi udhëtimin e tij drejt Jeruzalemit. Vendi i parë ku ai u ndal ishte santuari i famshëm në Montserrat. Me 24 mars 1522 ai lë shpatën dhe kamën në santuar “para altarit të Zojës, ku kishte vendosur të linte rrobat e veta për të veshur armët e Krishtit”.⁸⁷ Ai kaloi gjithë natën duke përgjuar me një bastun pelegrini në dorë. Nga Montserrat ai shkoi në një qytet të quajtur Manreza ku kishte ndër mend të ndalej vetëm për ndonjë ditë. Në fakt qëndroi gati një vit.

Manreza

(172) Injaci jetonte si pelegrin, duke lypur atë që ai kishte nevojë për të jetuar dhe duke kaluar gati gjithë

kohën e tij në lutje. Në fillim ditët e tij ishin të mbushura plot gëzim dhe ngushëllim të madh, por shpejt lutja u bë një vuajtje e Injaci provoi tundime të tmerrshme, merak e pikëllim aq të madh sa ai dëshironte me plot intensitet të hidhej nga një e çarë e madhe, që ishte në dhomën e tij”.⁸⁸ Më në fund paqja u kthye. Injaci, në lutjen, reflektonte mbi këtë “larmi shpirtrash”⁸⁹ të mirë dhe të këqinj në veprim në përvoja si e tija; ai filloi të kuptojë që liria e tij për t'iu përgjigjur Hyjit pësonte ndikim nga këto përvoja të “ngushëllimit” dhe të “pikëllimit”. “Në këtë periudhë Hyji sillej me të ashtu siç bën një mësues shkolle me një fëmijë: e mësonte”.⁹⁰

(173) Gradualisht pelegrini bëhet më i vëmendshëm dhe i ndjeshëm ndaj shtytjeve të brendshme të zemrës së tij dhe ndikimeve të jashtme të botës rrethuese. Ai njeh Hyjin, që i shfaqte dashurinë e tij dhe e ftonte të përgjigjej; por kujtohet dhe që liria e tij për t'iu përgjigjur kësaj dashurie mund të ishte e përmbajtur ose e bllokuar nga mënyra se si ai reagonte ndaj këtyre ndikimeve. Mësoi kështu t'i përgjigjej lirshëm dashurisë së Hyjit duke luftuar për të lëvizur gjithçka që pengonte lirinë e tij. Por “dashuria shfaqet me vepra”.⁹¹ Plotësia e lirisë të çonte në mënyrë të pashmangshme në një besnikëri të plotë. Përgjigja e lirë e Injacit ndaj dashurisë së Hyjit merr formën e një shërbimi plot dashuri: një përkushtimi të plotë në shërbim të Krishtit, që për Injacin, fisnik dhe kalorës, shihej si “Mbreti” i tij. Por një përgjigje me dashuri ndaj dashurisë së Hyjit nuk mund të jetë kurrë e mjaftueshme; logjika e dashurisë kërkon një përgjegje me një plotësi gjithnjë dhe më të madhe (“magis”).

(174) Kthimi në shërbim të Hyjit në dashuri u vertetua në një përvojë që i ndodhi një ditë ndërsa po qëndronte

gjatë bregut të lumit Cardoner. “Ndërsa qëndronte atje i ulur iu shndrit mendja: nuk pat një vizion, por njohu dhe kuptoi shumë parime të jetës së brendshme, e shumë gjëra hyjnore dhe njerëzore, me aq dritë sa gjithçka i dukej si e re ... Do të merrni një dritë të madhe në mendje ... Kaq sa nëqoftëse llogarit gjithë gjërat e huret e marra nga Hyji, dhe i vë së bashku, nuk i duket që të ketë mësuar shumë, gjatë gjithë rrjedhës së jetës së tij, deri gjashtëdhjetë, si në atë herë të vetme”.⁹²

(175) Injaci shkruante këto përvoja të veta në një libër të vogël, siç kishte filluar tashmë gjatë konvaleshencës së tij në Loyola. Në fillim këto shënime ishin vetëm për të, por gradualisht ai kuptoi që mund t'i përdorte për një qëllim më të gjerë. “Kur ai vinte re disa gjëra në shpirtin e tij dhe i gjente të vlefshme, mendonte që do të mund të ndihmonin dhe të tjerët dhe kështu i shënonte”.⁹³ Ai kishte gjetur Hyjin dhe zbulonte kështu domethënien e jetës. Që atëherë Injaci në çdo rast do të përpiqet të ndihmojë të tjerët për të njëjtin zbulim. Me kalimin e kohës këto shënime do të merrnin një formë më të strukturuar deri sa të përbënin bazën e një libri të vogël të quajtur “Ushtrimet Shpirtërore”,⁹⁴ i shkruar për të ndihmuar dhe të tjerët, për të drejtuar burrat dhe gratë në këtë përvojë të çlirimit të brendshëm që vendos njeriun në dispozicion të plotë ndaj Hyjit, për një shërbim besnik ndaj të afërmit.

(176) “Ushtrimet Shpirtërore” nuk paraqiten si një libër për t'u lexuar; përfaqësojnë më tepër drejtimin ndaj një përvoje, atë të një angazhimi aktiv që lejon të rritesh në një liri që të çon në shërbimin me besnikëri. Përvoja e

Injaci në Manresa mund të bëhet përvojë e jetuar nga secili.

Në “Ushtrimet çdo njeri ka mundësinë të zbulojë që, edhe pse mëkatar, ai është objekt i një dashurie personale të Hyjit, që e fton t'i përgjigjet dashurisë së tij. Kjo përgjigje fillon duke njohur praninë e mëkatisë dhe të efekteve të tij, çon në ndërgjegjësimin që dashuria e Hyjit është më e fortë se mëkati dhe në dëshirën për këtë dashuri që shëlbbon. Përgjigja e lirë dashurisë së Hyjit bëhet e mundur, falë ndihmës së tij, nga një aftësi gjithnjë dhe më e madhe në identifikimin e faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm që pengojnë lirinë dhe nga një dëshirë gjithnjë dhe më e madhe në angazhimin në luftën për t'i fituar. Në “Ushtrimet” zhvillohet pastaj një itinerar, që ka si synim të kërkojë të realizojë vullnesën e Atit, që ka shfaqur dashurinë e tij në njeriun dhe në jetën e Birit të tij, Jezu Krishtit; është fjala të zbulosh dhe të zgjedhësh mënyrat e veçanta falë së cilave ky shërbim i Hyjit në dashuri kthehet në realitet nëpërmjet një devotshmërie aktive ndaj të afërmit tënd.

Nga Jeruzalemi në Paris

(177) Pasi la Manrezën më 1523, Injaci vazhdoi udhëtimin e tij drejt Jeruzalemit. Përvojat e muajve të kaluar në Manreza kishin bërë të qartë shkëputjen prej jetës së tij të mëparshme dhe kishin vertetuar dëshirën për t'u dhënë plotësisht në shërbim të Hyjit; por kjo dëshirë nuk kishte ende një objekt krejt të qartë. Ishte vendimi i tij i prerë të stabilizohej në Jeruzalem për t'u kthyer shpesh për të vizituar vendet e shenjta dhe jetuar

në shërbim të të tjerëve, por nuk iu lejua që të qëndrojnë në këtë qytet të mundimshëm. “Pelegrini kishte kuptuar që qëndrimi i tij në Jeruzalem nuk ishte vullnesa e Hyjit. Që atëherë mendonte gjithnjë me vete se çfarë duhet të bënte. Ndjehej i prirur t’i kushtohej për njëfarë kohe studimit për të qenë në gjendje të ndihmojë njerëzit; kështu vendosi të shkojë në Barcelonë”.⁹⁵ Edhe pse ishte tridhjetë vjeç u kthye në bankat e shkollës për të mësuar gramatikën me fëmijët e qytetit. Dy vjet më pas kaloi në studimet universitare në Alkalà. Kur nuk studioje, i mësonte njerëzve udhët e Zotit duke i komunikuar atyre Ushtrimet e tij Shpirtërore. Por inkuzicioni nuk lejonte që një njeri, pa kryer studimet e teologjisë të fliste publikisht për gjëra shpirtërore. Më shumë se të tërhiqej në heshtje në lidhje me këto tema, të vetmet që i kishte me të vërtetë për zemër, i bindur që Hyji ishte duke e drejtuar, Injaci la Alkalà për t’u transferuar në Salamanka. Njerëzit e inkuzicionit do të vazhdonin ta persekutojnë deri sa në fund, ai la Spanjën dhe qëndroi në Francë në Universitetin e Parisit.

(178) Injaci qëndroi në Paris shtatë vjet. Ndonëse me predikimin dhe drejtimin shpirtëror të tij në Barcelonë, Alkalà dhe Salamanka kishte tërhequr shokë që do të qëndronin me të për pak kohë, vetëm në Universitetin e Parisit formoi rreth tij një grup të qëndrueshëm “miqsh të Zotit”.⁹⁶ Ishin shokët e tij të dhomës Pietro Fabro dhe Francesco Saverio “që më vonë ai i tërhoqi në shërbim të Hyjit nëpërmes Ushtrimeve Shpirtërore”.⁹⁷ Të tërhequr prej të njëjtit propozim katër të tjerë shumë shpejt do të bashkoheshin me ta. Secili prej këtyre burrave bëri personalisht përvojën e dashurisë së Hyjit dhe dëshira e tyre për t’iu përgjigjur ishte kaq e plotë sa jeta e tyre kishte ndryshuar plotësisht. Dhe meqë secili bashkoi me

të tjerët këtë përvojë, filloi të formohej në mes tyre një lidhje e thellë që do të zgjaste për gjithë jetën.

Nga Parisi në Romë

(179) Më 1534 ky grup prej shtatë shokësh mbërrin në një kapelë të vogël të manastirit të Montmartresë, në dyert e Parisit, dhe Pietro Fabro – i vetmi meshtar në mes tyre – celebroi një Meshë gjatë së cilës u shuguruan në Hyjin me votat e varfërisë dhe të dëlirësisë. Ishte gjatë këtyre ditëve që ata “do të përcaktonin të gjithë së bashku atë që donin të bënin: do të shkonin në Venecia, pastaj në Jeruzalem dhe do të konsumonin jetën e tyre për të mirën e njerëzve”.⁹⁸ Në Venecia gjashtë të tjerët u shuguruan meshtarë, në mes tyre edhe Injaci. Por vendimi për të shkuar në Jeruzalem nuk do të mund të realizohej.

(180) Lufta në mes forcave të krishtera dhe islamike bëri të pamundur udhëtimin në Lindje. Ndërsa prisnin që tensioni të binte dhe që pelegrinazhet të mund të rifillonin, shokët do të kalonin kohën e tyre duke u lutur, duke dhënë Ushtrime, duke punuar në spitale dhe në mes të të varfërve. Në fund, pasi kishin pritur një vit, duke parë që Jeruzalemi nuk realizohej, ata do të vendosnin që “me t’u kthyer në Romë të shkonin e t’i paraqiteshin Vikarit të Krishtit që të mund të shërbenin atje ku të gjykonte që kërkohet një lavdi më e madhe Hyjit dhe e mira e njerëzve”.⁹⁹

(181) Zgjidhja e tyre për t’u vënë në shërbim të Papës paraqiste mundësinë për t’u dërguar në anë të ndryshme të botës, kudo që Papa do të kishte patur nevojë për ta; “miqtë në Zotin” do të humbisnin. Pikërisht atëherë ata do të vendosnin të krijonin në mes tyre një formë më të

qëndrueshme e të përhershme lidhjeje, që do t'i mbante të bashkuar edhe kur do të ishin fizikisht të ndarë. Do t'i shtonin të mëparshëmve votën e të bindurit duke u bërë kështu një urdhër fetar.

(182) Tashmë drejt mbarimit të udhëtimit të tyre drejt Romës, në një kapelë të vogël gjatë rrugës, në lokalitetin e quajtur Storta; Injaci “do të merrni nga Hyji ndera të jashtëzakonshme ... Një ditë ... ndërsa në një kishë predikonte ndjeu në shpirt një heshtje të thellë dhe pau shumë qartë që Hyji Atë e vendoste me Krishtin Birin e tij, në një formë të tillë sa të mos mundte më në asnjë mënyrë të dyshonte që në fakt Hyji Atë e vendoste me Birin e vet”.¹⁰⁰ Shokët do të bëheshin shokë të Jezusit, pjesëtarë intimë në veprën e shëlbimit të Krishtit të Ringjallur, e zhvilluar brenda dhe nëpërmes Kishës, që vepron në gjysmën e botës. Shërbimi i Hyjit në Jezu Krishtin bëhet shërbim në Kishën e Kishës në misionin e saj të shëlbimit.

(183) Më 1539 shokët, që tashmë ishin dhjetë, u pritën mirë nga Papa Pali III, dhe Shoqëria e Jezusit u aprovua formalisht si Urdhër Fetar në 1540. Ndonjë muaj më vonë Injaci zgjidhet si Eprori i parë i Përgjithshëm.

B. Shoqëria e Jezusit angazhohet në veprimtarinë edukative: 1540-1556

(184) Edhe pse gjithë këta shokë të parë të Injacit ishin diplomuar në Universitetin e Parisit, qëllimi i vërtetë i Shoqërisë së Jezusit nuk parashikonte punën me institucionet edukative. Siç është përshkruar në “Formula” paraqitur nga Papa Palit III për aprovimin e saj, Shoqëria e Jezusit krijohej për “t`u marrë posaçërisht me

mbrojtjen dhe propagandimin e fesë dhe të progresit të njerëzve në jetë dhe në doktrinën e krishterë. Dhe kjo nëpërmes predikimeve publike, konferencave dhe çdo lloj tjetër shërbimi të Fjalës së Hyjit, nëpërmes Ushtrimeve Shpirtërore, mësimit të të vërtetës së krishterë fëmijëve dhe të paditurve dhe ngushëllimin shpirtëror të besimtarëve, me dëgjimin e rrëfimeve dhe me administrimin e sakramenteve të tjera.”¹⁰¹ Injaci dëshironte që jezuitët të ishin të lirë të shkonin nga një vend në tjetrin ku nevojat të ishin më të mëdha; ai ishte i bindur që disa institucione do t'i kishin lidhur e do të kishin penguar këtë lëvizje. Por shokët kishin një qëllim të vetëm: të donin dhe t'i shërbenin në çdo gjë Madhnisë Hyjnore”;¹⁰² ata dëshironin të shfrytëzonin çdo lloj mjeti që do t'i lejonte ata të realizonin sa më mirë këtë dashuri dhe këtë shërbim të Hyjit nëpërmes shërbimit të të afërmit.

(185) Shumë shpejt do të bëheshin evidente rezultatet pozitive që mund të merreshin nëpërmes edukimit të fëmijëve; nuk kaloi shumë kohë para se jezuitët të fillonin këtë veprimtari. Duke shkruar nga Goa (Indi) në 1542, Francesco Saverio shpreh me terma entuziaste mbi rezultatet e marra nga jezuitët me leksionet e dhëna fëmijëve në kolegjin e San Paolos; Injaci përgjigjej duke i nxitur. Një kolegji ishte krijuar në Gandia (Spanjë) për edukimin e atyre që përgatiteshin të hynin në Shoqërinë e Jezusit; duke marrë parasysh këmbënguljen e prindërve në 1546 ai filloi të pranojë fëmijë të tjerë të qytetit. E para shkollë “e jezuitëve”, në kuptimin e një institucioni më tepër për formimin e të rinjve studentë laikë u krijua në Mesina, në Sicili, më 1548. Kur pastaj u bë e qartë që edukimi nuk ishte vetëm një mjet i përshtatshëm për të nxitur zhvillimin njerëzor dhe shpirtëror, por dhe një

mjet efikas për mbrojtjen e fesë nga sulmet e reformatorëve, numri i shkollave të jezuitëve filloi të rritej me shpejtësi. Para vdekjes së tij, më 1556, Injaci aprovoi personalisht krijimin e 40 shkollave. Prej shumë shekujsh disa kongregacione fetare ndihmuan në zhvillimin e edukimit në fushën e filozofisë dhe teologjisë; ishte megjithatë diçka krejt e re në jetën e Kishës që anëtarët e këtij urdhëri të ri fetar të shtrinin veprimtarinë e tyre edukative në fushën e letërsisë dhe në drejtimin e shkollave. Bëhet i domosdoshëm aprovimi formal me anë të një dekreti papal.

(186) Injaci, ndërkohë, mbetet në Romë dhe ia kushtoi vitet e fundit të jetës së tij redaktimit të “Kushtetutave”¹⁰³ të urdhërit të ri fetar.

(187) Të frymëzuara në të njëjtin vizion të botës që është e vetë “Ushtrimeve Shpirtërore”, “Kushtetutat” shfaqin aftësinë e Injaci në tregimin e qëllimeve më të larta duke sugjeruar në të njëjtën kohë mjetet e sakta dhe konkrete për t'i realizuar. E ndarë në dhjetë “Pjesë”, vepra është një manual formimi për jetën e jezuitëve.

Redaktimi i parë përmbante në pjesën e IV direktiva për edukimin e të rinjve, që përgatiteshin të bëheshin jezuitë; meqë në të njëjtën kohë në të cilën shkruante Kushtetutat, Injaci ishte duke aprovuar krijimin e shkollave të reja, ai ripreku pjesërisht këtë pjesë të IV për të përfshirë parimet që do të duhej të udhëhiqnin punën edukative në këto shkolla. Ky seksion i Kushtetutave është pra burimi më i mirë për të njohur mendimin e qartë të Injaci mbi apostulatin edukativ, edhe pse pjesa e IV ishte përfunduar më parë se Injaci të

kuptonte rolin e konsiderueshëm që edukimi do të kishte marrë në punën apostolike të Shoqërisë.

Hyrja e pjesës së IV deklaron përfundimin: “qëllimi që Shoqëria synon drejtpërdrejtë është të ndihmojë njerëzit e objekteve të saj dhe ato të të afërmit të arrijnë qëllimin e fundit për të cilin janë krijuar. Për këtë, përveç shembullit të jetës, janë të nevojshme doktrina dhe aftësia në mënyrën e paraqitjes”.¹⁰⁴

Objektivat prioritarë të formimit të jezuitëve do të bëheshin prioritet i institucioneve edukative të Shoqërisë: këmbëngulje mbi studimet humanistike që duhet të ndiqen prej filozofisë e teologjisë,¹⁰⁵ një rregull për t'u ndjekur me kujdes në studimin e shumë fushave njohjeje,¹⁰⁶ një përsëritje e shpeshtë e përmbajtjeve të dhëna dhe një futje aktive e studentëve në edukimin e tyre.¹⁰⁷ Shumë kohë duhej të llogaritej për të kuptuar shkrimin me një stil të efektshëm.¹⁰⁸ Eshtë thelbësor roli i Rektorit si qendër autoriteti, frymëzimi dhe bashkimi.¹⁰⁹ Nuk bëhej fjalë në trajtimin e metodave të reja pedagogjike; Injaci njihte mirë çfarë ishte mungesa e metodës dhe cilat ishin metodat e shkollave të shumta, veçanërisht ato të vëmendshme dhe të sakta të Universitetit të Parisit. Ai zgjodhi dhe përshtati ato elementë që do të ishin më të efektshëm për realizimin e objektivave të edukimit të jezuitëve.

Kur flet qartë për shkollat e studentëve laikë, në kapitullin e shtatë të pjesës së IV, Injaci jep udhëzime të veçanta mbi pak argumente. Ai këshillon për shembull që studentët (në këtë kohë gati të gjithë të krishterë) të jenë “ të instruktuar mirë në doktrinën e krishterë”.¹¹⁰ Kështu konform parimit bazë sipas të cilit nuk duhet të jepet

ndonjë kompensim i përkohshëm për asnjë veprimtari të jezuitëve, nuk duhet kërkuar ndonjë pagesë për konvikt.¹¹¹ Duke lënë mënjanë këto apo pak detale të tjera, ai kufizohet në zbatimin e një parimi, që gjendet kudo në Kushtetutat: “Meqë në raste të veçanta është i nevojshëm shumë diversitet, sipas rrethanave të vendit dhe njerëzve, nuk do të vlerësohet këtu ndër gjëra të veçanta vetëm nëqoftëse duhet thënë që janë rregulla që parashikojnë me sa është e nevojshme në çdo kolegji.”¹¹² Në një shënim më pas ai sugjeron: “mund t’i adoptohet kolegjeve të tjera ajo pjesë që atyre i përshtatet nga ‘Rregullat e Kolegjit Roman’ ”.¹¹³

(188) Në një letër të tij Injaci premtonte të zhvillojë më tej rregullat apo parimet bazë që duhet të udhëheqin gjithë shkollat. Por ai këmbëngulte në thënien që nuk do të kishte mundur të stabilizonte këto parime deri kur nuk do të kishte mundur t’i derivonte nga përvojat konkrete të atyre që ishin angazhuar në veprimtarinë edukative. Injaci vdiq në orët e para të 31 korrikut të vitit 1556, para se të mund të mbante këtë premtim.

C. Ratio Studiorum dhe historia e kohëve të fundit.

(189) Në vitet pas vdekjes së Injazit jo të gjithë jezuitët aprovonin që angazhimi për shkollat të ishte një aktivitet i vetë Shoqërisë së Jezusit; bëhej fjalë për një debat që zgjati për një pjesë të mirë të shekullit të XVII. Megjithatë angazhimi i jezuitëve në edukimin vazhdoi të rritej me shpejtësi. Nga katërdhjetë shkolla që Injaci kishte aprovuar personalisht, të paktën tridhjetë e pesë ishin në aktivitet kur ai vdiq, edhe pse numri i përgjithshëm i jezuitëve nuk kishte arritur akoma

mijëshin. Në katërdhjetë vitet që vijuan, shkollat e jezuitëve arritën numrin 245. Premtimi për të zhvilluar në një dokument karakteristikat e përbashkëta në të gjitha shkollat e Shoqërisë po bëhej një nevojë e vërtetë.

(190) Eprorët e jezuitëve që do ta pasonin do të nxisin një shkëmbim idesh duke u nisur nga përvoja konkrete. Pa cënuar parimin e Injazit, që dëshironte të merrte parasysh “rrethanat e vendit dhe të njerëzve”, u bë e mundur kështu të vendosej një program themelor dhe një pedagogji me baza, që rridhnin nga kjo përvojë dhe t’i komunikoheshin gjitha shkollave të Shoqërisë. Pasi një periudhë shkëmbimesh intensive në mes shkollave të ndryshme.

(191) Ashtu siç kishte dëshiruar Injaci redaktimet e para të një dokumenti të përbashkët do të zgjidhnin si pikënisje “Rregullat e Kolegjit Roman”. Ati i Përgjithshëm Claudio Acquaviva emëroi një komision ndërkombëtar prej gjashtë jezuitësh; ai u mblodh në Romë për të përshtatur dhe modifikuar këto bota të para mbi bazën e përvojës së fituar në pjesë të tjera të botës. Më 1586 dhe pastaj përsëri më 1591 ky grup publikoi disa dokumenta më të plotë, që u shpërndanë gjerësisht, që të mund të komentoheshin dhe korrigjoheshin. Shkëmbimet e reja të ideve, mblodhjet e komisioneve dhe puna e redaktimit do të përfundonin më së fundi me 8 janar të 1599 me publikimin e një “Ratio Studiorum” përfundimtare.

(192) Në formën e saj përfundimtare “Ratio Studiorum” ose “Plani i studimeve” për shkollat e jezuitëve, është një manual që kërkon të ndihmojë mësuesit dhe drejtuesit në

drejtimin e përditshëm të jetës shkollore; konsiston në një seri “rregullash” apo direktivash praktike që i përkasin temave si drejtimi i shkollës, formimi dhe shpërndarja e mësuesve, curriculum apo programi i studimeve dhe metodave të mësimdhënies. Si pjesë e IV e “Kushtetutave”, është fjala për një vepër origjinale por më tepër një përmbledhje të metodave më efikase pedagogjike të kohës, të verifikuara e përshtatura qëllimeve të instituteve të jezuitëve.

Qartësisht i referohen pak parimeve që vijnë më poshtë nga përvoja e Injacet dhe e shokëve të tij, që ishin përmbledhur tashmë në “Ushtrimet Shpirtërore” dhe në “Kushtetutat”. Parime të tilla ishin radhitur në të njëjtin

dorëshkrim, por në botimin përfundimtar të 1599 ata ishin supozuar. Marrëdhënia midis mësuesit dhe nxënësit, për shembull, duhet të jetë analoge me marrëdhënien në mes atij që jep Ushtrimet dhe personit që i bën; meqë autorët e “Ratio” dhe gati të gjithë mësuesit e shkollave ishin atëherë jezuitë, një referim i tillë dihej që më parë. Edhe pse nuk ishte i deklaruar qartë, fryma e “Ratio” dhe ajo që i dha jetë të parave shkolla të jezuitëve ishte vizioni i vetë botës së Injacet.

(193) Procesi që kishte çuar në publikimin e “Ratio” i dha origjinë një sistemi shkollash prej të cilit forca dhe ndikimi rridhte nga ky shpirt i përbashkët që ishte konkretizuar në parime të përbashkëta pedagogjike. Pedagogjia bazohej mbi përvojën dhe perfeksionohet e përshtatej falë pajtimit të vazhdueshëm me të. Ky ishte i pari sistem edukativ që bota e njohu.

(194) Sistemi i shkollave të jezuitëve u zhvillua duke u shtrirë për më shumë se 200 vjet deri në ditën e fundit të tij tragjik dhe të papritur. Kur Shoqëria e Jezusit u mbyll më 1773, me urdhër të Papës, një rrjet prej 845 institutesh shkollore të shpërndarë në Europë, Amerikë, Azi dhe Afrikë u shkatërrua gati plotësisht. Jezuitët vazhduan të drejtonin një numër të vogël shkollash në territorin e Ruisë, ku mbyllja nuk hyri asnjëherë në fuqi.

(195) Kur Piu VII, kërkon të rivendosë Shoqërinë e Jezusit, njëra nga arsytet që paraqiti ai për këtë vendim ishte që “Kisha Katolike do të mund të përfitonte përsëri nga përvoja e edukatorëve”.¹¹⁵ Veprimtaria edukative rifillon pothuajse menjëherë e pak më vonë, në 1832, u publikua në titull eksperimental një përpunim i “Ratio Studiorum”. Por ky përpunim nuk u aprovua asnjëherë përfundimisht. Fortunat e Europës të shekullit XIX, të shoqëruara nga revolucione dhe dëbime të vazhdueshme të jezuitëve nga vende të ndryshme dhe kështu dhe prej shkollave të tyre, penguan një rinovim të efektshëm të filozofisë edukative apo të pedagogjisë së Shoqërisë. Shumë shpesh viheshin re ndarje brenda Shoqërisë, dhe institutet e saj shkollorë konsideroheshin si një mbështetje ideologjike njëherë për njërin herë për tjetrin vend pjesëmarrës në luftë. Megjithë këtë situatë të vështirë, sidomos në vendet e porsakrijtura të Amerikës, të Indisë dhe të Azisë Lindore, shkollat e Shoqërisë filluan përsëri të përhapeshin.

(196) Në shekullin e XX, veçanërisht në vitet pas luftës së dytë botërore, institutet e jezuitëve janë rritur pa masë në numër dhe përmasa. Kongregacione të ndryshme të përgjithshme, me Dekretet e tyre, hodhën bazat për një rinovim shpirtëror, në mënyrë të veçantë, pas Koncilit të

II të Vatikanit, Dekreti 28 i Kongregacionit të XXXI të Përgjithshëm, don të zbatohet orientimet e Koncilit në shkollat tona. Sot apostulati pedagogjik i Shoqërisë së Jezusit zhvillohet në më shumë se 2000 shkolla tepër të ndryshme si tipe dhe nivele. Sot, 10000 jezuitë punojnë në to në bashkëpunim të ngushtë me gati 100000 laikë, duke u angazhuar në edukimin e më shumë se një milion e gjysëm të rinjsh e të rritursh në 56 vende të botës.

(197) Sot edukimi i jezuitëve nuk është dhe nuk mund të jetë një “sistem” i njëjtë si tip me atë të shekullit të XVII; edhe pse shumë parime të origjinalit “Ratio Studiorum” janë edhe sot e kësaj dite të vlefshme, nuk mund t’i vendoset të gjitha shkollave në pjesë të ndryshme të botës një curriculum dhe një strukturë e njëjtë. Duhet më tepër të njohësh nevojat e ndryshme të kulturave dhe besimeve të ndryshme dhe të parashikosh një përshtatje të vazhdueshme të metodave pedagogjike në lidhje me kultura të ndryshme.

(198) Kjo nuk do të thotë që nuk është e mundur të mendosh edukimin injacian si një “sistem”. Në shekullin e XVI ishte një frymë e përbashkët, vizioni i vetë botës së Injacit, që u dha mundësi shkollave të jezuitëve të përpunojnë parime dhe metoda të përbashkëta; e njëjta frymë, e bashkuar tani një qëllimi të përbashkët – në masën në të cilën parime dhe metoda më karakteristike qenë futur në “Ratio Studiorum” – që e aftë të krijojë sistemin shkollor të jezuitëve në shekullin e XVII. Ky frymëzim i njëjtë i përbashkët i pandarë në përcaktimin e qëllimeve kryesore, të objektivave dhe të linjave të përgjithshme të drejtimit të shkollave, prej të cilave ato rrjedhin, mund të gjallërojë edhe sot veprimtarinë edukative të jezuitëve në gjithë botën. Kjo është e

mundur dhe kur zbatimet konkrete janë shumë të ndryshme dhe kur detaje të shumta të jetës së shkollës përcaktohen nga faktorë kulturorë apo nga struktura edukative jashtë Shoqërisë.

Shtesa II

NJE SKEME

(Kjo skemë paraqet në mënyrë skematike lidhjet në mes vizionit shpirtëror të Injacit dhe karakteristikave të edukimit injacian. Nëntë pikat e kolonës së parë përsërisin pohimet injaciane të zgjedhura si temë e nëntë seksioneve të pjesës kryesore të dokumentit; shënimet në këto pika të çojnë në shkrimet e Injacit – në vend të parë në “Ushtimet Shpirtërore” dhe në “Kushtetutat” – dhe në paragrafet e përmbledhjes historike, që ndërtojnë Shtesën I. Të 28 karakteristikat themelore të edukimit injacian përsëriten në kolonën e dytë, të vendosura grafikisht në një mënyrë, që tregon origjinën e tyre prej vizionit të vetë botës së Injacit. Nuk kërkohet këtu një paralelizëm i saktë: më tepër se të flasësh për një zbatim të drejtpërdrejtë, do të ishte më e arsyeshme të thuhej që karakteristikat rrjedhin, kanë rrënjën në vizionin e Injacit).

Vizioni i vetë Shën Edukimi injacian ... Injacit mbi botën

1. Për Injacin Hyji është Krijuesi dhe Ati, E Mira e Pambaruar, realiteti i vetëm absolut;¹¹⁶

çdo realitet tjetër bu-ron nga Hyji dhe ka vlerë vetëm në masën që na çon tek Ai.¹¹⁷

Hyji është i pranishëm në jetën tonë “duke u lodhur për ne” në çdo gjë;

Ai mund të zbulohet përmes fesë në ngjarje natyrore dhe njerëzore,

në tërësinë e historisë dhe në mënyrë të veçantë në jetën e çdo njeriu.¹¹⁸

2. Çdo njeri është personalisht i njohur dhe i dashur nga Hyji. Kjo dashuri fton për një përgjigje, por që një përgjigje të jetë automatikisht njerëzore, duhet të jetë e lirë.¹¹⁹

Prandaj, për t`iu përgjigjur

- është një mjet apostolik. nga Hyji dhe ka vlerë vetëm në masën që na çon tek Ai.¹¹⁷ - përfshin një aspekt fetar, që përshkon të gjithë veprimtarinë edukative. pohon që bota është pozitive në themel të saj. - nxit dialogun midis fesë dhe kulturës. - nxit formimin integral të çdo individi brenda bashkësisë njerëzore. - vë theksin në kujdesin e veçantë që duhet të kemi për çdo njeri.

dashurisë së Hyjit njeriu duhet të jetë:

- i lirë për të thënë të vërtetën dhe për të pranuar përgjegjësitë e veprimeve të veta dhe pasojat e tyre: i lirë të jetë besnik;

- i lirë të veprojë në bazë të fesë drejt asaj lumturie që është qëllimi i jetës: i lirë për t`u sakrifikuar me të tjerët në shërbim të Mbretërisë së Hyjit për shpëtimin e gjithësisë.¹²⁰

- zhvillon dëshirën për të mësuar vazhdimisht gjatë gjithë jetës.

- nënvizon rolin aktiv të studentit.

3. Për shkak të mëkatit dhe të rrjedhëve të tij, liria për t`iu përgjigjur dashurisë së Hyjit nuk është automatike. Me ndihmën dhe forcën që vijnë nga dashuria e Hyjit shpëtimtar, ne jemi të angazhuar në një luftë të vazhdueshme me qëllim që të njohim dhe të mënjanojmë pengesat që na dalin përpara në arritjen e lirisë së vërtetë – përfshirë rrjedhojat e mëkatit – dhe në zhvillimin e aftësive të nevojshme për ushtrimin e lirisë së vërtetë.¹²¹

a. Kjo liri kërkon një - nxit njohjen realiste, njohje autentike, një dashurinë dhe pranimin e dashuri dhe një pranim të vetvetes.

vetvetes, që lidhen me përkushtimin për të qenë të lirë nga çdo lidhje e tepërt me të mirat materiale, stimën, shëndetin, pushtetin dhe çdo gjë tjetër, deri me vetë jetën tonë.¹²²

b. Liria e vërtetë kërkon - pajis me njohjen realiste të një njohje realiste të botës në të cilën jetojmë.

forcave të ndryshme të pranishme në botën që na rrethon; ajo përfshin shkëputjen nga përfytyrimet e shtrembëta të realitetit, nga vlerat e tjetërsuara, nga qëndrimet e ngrira dhe nga pozicionet e ngushta ideologjike.¹²³

c. Për të arritur lirinë e - është një edukim në vlera.

vërtetë duhet të mësojmë të njohim dhe të çmojmë influksat që e ndihmojnë apo e pengojnë atë: valët e zemrës sonë, përvojat e kaluara të çdo tipi, marrëdhëniet reciproke me të tjerët, dinamikat e historisë, të strukturave sociale dhe të kulturës.¹²⁴

4. Vizioni i botës së Injazit - propozon Krishtin si mo-

është përqëndruar mbi del të jetës së njerëzve.

personin historik të Jezu Krishtit.¹²⁵ Ai, me përgjigjen e plotë që i jep dashurisë së Hyjit duke u vënë në shërbim të tjerëve, është modeli për jetën e njerëzve.

Ai ndan me ne kushtet - realizon një kujdes baritor njerëzore dhe na fton ta të përshtatshëm.

ndjekim nën flamurin e kryqit me një përgjigje dashurie ndaj Atit.¹²⁶

Ai është i gjallë midis - celebron fenë me lutjen nesh dhe mbetet për- vetjake dhe të përbashkët, gjithnjë Njeriu për të tjerët në adhurim dhe në shërbim. në shërbim të Hyjit.

5. Një përgjigje ndaj dashurisë së Hyjit, e lirë dhe që zë fill nga dashuria, nuk mund të jetë thjesht spekulluese dhe teorike.

Me çdo kusht parimet - përgatit për një angazhim spekulluese duhet të çojnë aktiv në jetë.

në një veprim vendimtar: “dashuria shprehet me vepra”.¹²⁷

Injaci kërkon nga burrat - është në shërbim të një feje dhe gratë një angazhim që nxit drejtësinë.

tërësor dhe aktiv. Për t'i përngjarë Krishtit e të jesh me të vërtetë si ai duhet të kthejmë në praktikë idealet

tona

në realitetin familjar, në punë, në lëvizjet shoqërore, në strukturat juridike dhe në veprimtaritë fetare, në politikë.¹²⁸

6. Për Injacin, ndaj thirrjes së Krishtit nuk mund të ketë vend tjetër përveçse brenda dhe nëpërmjet Kishës Katolike, mjeti përmes të cilit Krishti me anë të sakramendeve është pranishëm në botë.¹²⁹ Maria, Nëna e Krishtit, është modeli i kësaj përgjigjeje.¹³⁰

Injaci dhe dishepujt e tij parë ishin që të gjithë meshtarë dhe deshën të vinin Shoqërinë e Jezusit në shërbim të Vikarit të Krishtit, “për t’i dërguar në çdo pjesë të botës ku ai do ta gjykonte të nevojshme për lumninë e Hyjit dhe për të mirën më të madhe të njerëzve”.¹³¹

7. Injaci ka këmbëngulur vazhdimisht mbi “magis” – për më ‘shumë’. Tensioni i tij i qëndrueshëm ka qenë për

një shërbim me vlera me të mëdha ndaj Hyjit, i realizuar me një ndjekje gjithnjë e më besnike tek Krishti. E njëjta gatishmëri ka gjallëruar veprën apostolike të dishepujve të parë.

Përgjigja konkrete ndaj dashurisë së Hyjit duhet të jetë e “një vlere më të madhe”.¹³²

8. Kur Shën Injaci bëri përvojën e dashurisë ndaj Hyjit, zbuluar në Krishtin, e filloi t’i përgjigjet me dhurimin e vet shërbimit të Mbretërisë së Hyjit, ai vendosi ta ndajë këtë përvojë dhe mblodhi rreth bënë “miqtë e Hyjit”, në shërbim të të tjerëve.¹³³

Forca e një bashkësie, që vihet në shërbim të Mbretërisë është më e madhe se ajo e një njeriu të vetëm apo e një grupi njerëzish.

9. Injaci dhe dishepujt e tij një procesi të shëm “vlerësimi” dual dhe të përbashkët, të

zhvilluar përherë në një nga një vizion i përbashkët kontekst lutjesh. Një dhe nga objektiva të reflektim të ngjashëm, të përbashkëta. shoqëruar me lutje, mbi - ndihmon për t'i siguruar rezultatet e veprimtarisë së veçanërisht mësuesve, raste tyre, udhëhiqte dishepujt të formimit të vazhdueshëm edhe në rishikimin e dhe të trajnimit profesional. metodave të shfrytëzuara prej tyre në kërkimin këmbëngulës për një shërbim “më me vlerë” (“magis”) ndaj Hyjit.¹³⁴

Shënime

1. Pedro Arrupe, S.I., “Nuestros Colegios Hoy y Mañana”, § 10. Fjalim mbajtur në Romë, më 13 shtator 1980; publikuar në “Acta Romana Societatis Jesu”, vol. XVIII (Ediz. Università Gregoriana, 1981). Përkthimi në italisht: “I nostri collegi: oggi e domani”, supplemento al n.3/1981 di ‘Notizie dei Gesuiti d’Italia’. Nënvizimet janë shtuar. Që tani e më pas i shkurtuar NCHM.
2. Teksti zyrtar është në latinisht: “Apostolicam Actuositatem”; një përkthim në italisht përbri tekstit në latinisht mund të gjindet në: ‘Enchiridion Vaticanum 1. Documenti del Concilio Vaticano II’ (Ediz. Dehoniane, Bologna, 11^a ed., 1979), fq. 518-577.
3. Kongregacioni i XXXII i Përgjithshëm i Shoqërisë së Jezusit, Dekreti 4, “La nostra missione oggi: diaconia della fede e promozione della giustizia”, n.2. Përkthimi italisht në “Decreti della G.G. XXXII d.C.d.G. – 1974-75. Roma 1977.
4. Ibid., n. 9.
5. Dy shprehjet janë përdorur shumë herë nga Atë Pedro Arrupe në shkrimet dhe fjalimet e tij. Probabilisht hera e parë që në Valenca, në Spanjë, më 31 korrik 1973, në një fjalim në Kongresin e dhjetë të Konfederatës Europiane të Ish-Nxënësve të Shoqërisë së Jezusit: “La promoción de la justicia y la formación en las Asociaciones de Antiguos Alumnos”. Përkthim italisht në: Pedro Arrupe S.I., ‘Uomini per gli altri’ (A cura della Federazione Italiana Ex-Alumni d.C.d.G., Roma 1984).fq. 141-187.
6. Shprehja gjendet në “Kushtetutat” dhe në shkrime të tjera të Injacid. Atë Pedro Arrupe e zgjedh si temë në një nga konferencat e tij të fundit, e mbajtur në anglisht më 18 janar 1979 gjatë ‘Kursit Injacion’, organizuar nga ‘Centro Ignaziano di Spiritualità (CIS)’; përkthimi italisht : “El modo nuestro de proceder: Il nostro modo di agire”, in supplemento al n. 9-10/1979 di ‘Notizie dei gesuiti d’Italia’.
7. “Costituzioni della Compagnia di Gesù”, (238) e passim. Fraza e cituar në tekst është një parim themelor i Injacid dhe një nga shprehjet e tij të preferuara.

8. “Gjërat e tjera mbi faqen e tokës janë krijuar për njeriun që ta ndihmojnë në arritjen e qëllimit për të cilin është krijuar. Prej këtu rrjedh që njeriu duhet të na shërbejë aq më tepër sa më shumë ndihmojnë atë për të ndjekur qëllimin për të cilin është krijuar e aq më shumë duhet të na çlirojë kur ta pengojnë”. “Esercizi Spirituali”, § 23). Shpesh i referohemi këtij teksti si “tantum quantum”, prej fjalëve të përdorura në tekstin latinisht të Ushtrimeve.
9. “Ushtrime Shpirtërore”, § 236.
10. Nga “God’s Grandeur”, të Gerard Manley Hopkins, S.I.
11. Shih Zanafillën 1,27.
12. “Ideali ynë është më afër njeriut grek, në versionin e tij të krishterë, të ekuilibruar, të qartë e konstant, i hapur ndaj gjithçkaje që është njerëzore”. (NCHM, § 14).
13. Përgjigja e fesë është e trajtuar më tepër në seksionet 4 e 6.
14. Papa Pali VI në një letër shkruar Shoqërisë së Jezusit (“Acta Apostolicae Sedis” 57, 1965, fq. 514); i njëjti mision është rinovuar nga Papa Gjon Pali II, më 2 shtator 1983, në homelinë e tij Etërve Kongregatë të Kongregacionit të XXXIII të Përgjithshëm. (Shih ‘Decreti della Congregazione Generale 33^a della C.d.G.’ – Roma, 1983, fq. 78).
15. Karakteristika “mjet apostolik” është e trajtuar më gjerësisht në seksionin 6.1.
16. “Ushtrime Shpirtërore”, § 23.
17. Për kthimin flitet më gjerë në seksionin 3.
18. Për “inkulturimin” flitet në Dekretin 5 të Kongregacionit të XXXII të Përgjithshëm. Shih shënimin 3.
19. Ky kujdes për studentin si person mbetet e do të duhet të mbetet, për sa është e mundur, karakteristika e thirrjes tonë ... E megjithatë duhet të ruajmë në një mënyrë apo tjetër këtë kontakt personal me ata që frekuentojnë kolegjet dhe shkollat tona”. (Atë i Përgjithshëm Peter-Hans Kolvenbach, S.I., ‘Ndërhyrje ... në Kuvendin vjetor të Delegatëve për edukimin, të Provincave Europiane të Shoqërisë së Jezusit’ – Romë më 18 nëntor 1983; në ‘Notizie dei gesuiti d’Italia, n. 4/1984, fq. 97).
20. NCHM, § 13.
21. Për një zhvillim më të gjerë mbi formimin e përhershëm, shih seksionin 9.3.
22. Falje dhe kthim janë koncepte fetare, të trajtuara më gjerësisht në seksionin 6.
23. Shih ‘meditimi i dy flamujve` në “Ushtrime Shpirtërore”, §§ 136-148.
24. “Në këtë fushë, si në shumë të tjera nuk duhet të hezitoni para perspektivës së një angazhimi politik. Sipas Konkilit të dytë të Vatikanit, është ky një rol i veçantë i laikëve. E ju nuk mund t’i ikni, kur gjendeni të angazhuar në luftën në favor të strukturave, që bëjnë botën me të vërtetë më njerëzore, që i japin jetë krijimit të ri që Krishti ka premtuar”. (Ati i Përgjithshëm Peter-Hans Kolvenbach, S.I., në fjalimin mbajtur më 20 korrik 1986 për sesionin e hapjes së Kongresit botëror të Ish-Nxënësve, Versailles, Francë. Origjinali frëngjisht në ‘ETC – Ensemble’, 40, 1986. Përkthimi italisht në ‘Tra Noi. Alunni ed Ex-Alunni del Sociale’, n. 7-8-9/1986).
25. Sipas “Ushtrime Shpirtërore”, §§ 143-147.
26. “Është shumë e rëndësishme të theksojmë që konsiderimi i misionit të Jezusit nuk është propozuar që të soditet, apo për të kuptuar më mirë personin e Jezusit, por saktësisht që ky person të na ftojë me një ‘thirrje’ që kërkon si përgjigje të përshtatshme një ‘ndjekje’; ... pa këtë gatishmëri nuk mund të ketë një kuptim të vërtetë. Në logjikën e Shën Injacit – më në heshtje se hapur – është e dukshme që sa herë i referohemi Jezusit, dhe përsa i përket Jezusit historik, është nënvizuar për të krishterët e sotëm një pikëpamje e privilegjuar: ajo e ndjekjes.” (Jon Sobrino, “Cristologia desde America Latina” Ediciones CRT, Mexico, 1977; fq. 329).
27. “Kujdesi baritor” nxit pjekurinë shpirtërore që është më tepër se zhvillim i thjeshtë njerëzor. Ai megjithatë nuk kufizohet me marrëdhëniet në mes Hyjit dhe personit në veçanti, përfshin dhe marrëdhëniet me të tjerët si shprehje dhe zgjerim të marrëdhënies me Hyjin. Për këtë “feja” të çon në “angazhim”; zbulimi i Hyjit sjell t’i shërbesh Hyjit në shërbimin të tjerëve në bashkësi.
28. “Ata që dalin nga kolegjet tona duhet të kenë fituar proporcionalisht me moshën e pjekurinë e tyre, një formë jete që të jetë në vetvete shpallje e dashurisë së Krishtit, të besimit që vjen nga Ai dhe çon tek Ai dhe të drejtësisë që Ai ka shpallur”. (NCHM, § 12).
29. Shih Shtesën I për një përshkrim të shkurtër të “Ushtrimeve Shpirtërore”.
30. Kjo temë është trajtuar më gjerësisht në seksionin e ardhshëm e në seksionin 9.
31. “Ushtrime Shpirtërore”, § 230.
32. Ibid., § 167.
33. “Formula e Institutit”, që është përshkrimi origjinal i Shoqërisë së Jezusit, shkruar nga Injaci, përdor këtë parim themelor të “Ushtrimeve Shpirtërore”: “Secili, në Shoqërinë tonë ... don të shërbejë për Perëndinë nën flamurin e kryqit ... që të bindet thellësisht se bën pjesë në një Shoqëri e krijuar me qëllim kryesor të merret veçanërisht me mbrojtjen dhe propagandimin e fesë e progresin e njerëzve në jetën e doktrinën e krishterë”. (“Formula”, n.1).
34. Atë Peter Hans Kolvenbach në Kongresin botëror të Ish-Nxënësve në Versailles. Shih shënimin 24.
35. Tema e “fesë” është zhvilluar në seksionet 1 e 4. Ky seksion përqëndrohet mbi “drejtësinë”. Është e rëndësishme pra të mos

- ndahen këto dy koncepte. “Jetësia reale e këtij bashkimi feje e drejtësie mishërohet në një ndjekje të ngushtë të Jezusit historik. Propozojmë si elementë themelorë të kësaj ndjekjeje pikat e mëposhtme:
- Në lajmin e Mbretërisë e në luftën e saj kundër mëkatit, Jezusi ka hyrë në konflikt me persona e struktura, që, si rrjedhojë e situatës së tyre objektivisht mëkatore, i kundërviheshin Mbretërisë së Hyjit.
 - Baza për bashkimin në fe e drejtësi gjindet në bashkimin e tyre të pandashëm me urdhërimin e ri të dashurisë. Nga njëra anë lufta për drejtësi është forma që dashuria duhet të marrë në një botë të padrejtë; nga ana tjetër Testamenti i Ri është shumë i qartë në të treguarit që dashuria për njerëzit përbën rrugën kryesore që na çon në dashurinë e Hyjit duke zbuluar që duhemi nga Ai. (‘Riunione Latino-Americana sul tema della Educazione’, Lima, Perù, luglio 1976; pubblicato dal CERPE; Caracas, Venezuela, fq. 65).
36. Kongregacioni i XXXII i Përgjithshëm, Dekreti 4, n.4. Shih shënimin 3.
 37. NCHM, § 11.
 38. Nga “Prefacioni” për festën e Krishtit Mbret.
 39. Në fjalimin Presidentëve e Rektorëve të Universiteteve dhe të shkollave të mesme të jezuitëve, me rastin e takimit të tyre në Frascati, Itali, më 5 nëntor 1985, Ati i Përgjithshëm Peter-Hans Kolvenbach ka dhënë mjaft shembuj se si opcioni për nxitjen e drejtësisë mund të gjallërojë kurse të ndryshme akademikë. (Shih ‘L’università dei gesuiti oggi’, “Notizie dei gesuiti d’Italia”, n. 1/1986, fq. 2-10).
 40. Shih Gabriel Codina S.I., “Fede e Giustizia nel contesto dell’attività educativa”. (E publikuar në “Education SI” 56, 1986, fq. 12-13).
 41. Shih Codina, op.cit., fq.11.
 42. Ibid., fq. 14-15. Nënvizimet janë shtuar.
 43. Shih shënimin 5. Të “tjerët” e kësaj shprehjeje, shumë shpesh e përsëritur, janë i “afërmi” i parabolës së Samaritanit të Mirë (Luka 10,29-37). Citimi në tekst është një zhvillim i kësaj ideje që ka thelluar Atë Arrupë (shih shënimin që vjen më pas).
 44. Sipas “Uomini per gli Altri” (shih shënimin 5), fq.143.
 45. Shembuj konkretë të nënvizimit të vlerave të bashkësisë gjinden në çdo seksion të këtij përshkrimi të Karakteristikave të edukimit injacian.
 46. “Krahas ndikimit të familjes, shembulli i të rriturve të shkollës dhe klima e krijuar nga ato, do të përbëjnë faktorin që ka ndikimin më të madh në përpjekjen për të edukuar në një fe që nxit drejtësinë”. (Robert J. Starratt, S.I., “Diffondere semi di fede e giustizia”. I publikuar nga Shoqëria e shkollave të mesme të Jezuitëve – JSEA – Uashington, D.C., USA; fq. 17).
 47. Shprehja përdoret shpesh në dokumentat e fundit të Kishës e të Shoqërisë. Diskutohet shumë mbi kuptimin e saj të plotë; ajo nuk do të thotë që është një zgjedhje për një kategori të veçantë personash me përjashtimin e të tjerëve. Kuptimi i saj në kontekstin e aktiviteteve edukative është përshkruar në këtë seksion 5.4.
 48. “Shoqëria e Jezusit ka një qëllim. Ne jemi për të gjithë. Të pasur e të varfër, të shtypur e shtypës, të gjithë. Asnjë nuk është i përjashtuar nga apostulati ynë. Kjo vlen edhe për shkollat tona”. (Pedro Arrupe S.I., “Ndërrhyrje gjatë Seminarit mbi edukimin në shkollat e mesme”, në NCHM, fq. 14).
 49. Problemi i pranimit të nxënësve paraqet ndryshime të dukshme nga shteti në shtet. Kur nuk ka financime shtetërore shkolla mbahet nëpërmes pagesës së konviktit e nëpërmes dhuratave. Interesi për drejtësinë duhet të përfshijë paga të drejta e kushte të mira pune për të gjithë të ngarkuarit e shkollës. Duhet dhe të marrim në konsideratë zgjedhjen për të varfërit.
 50. NCHM, § 8.
 51. Shih Codina, op. cit., fq. 8. Një ekspozim më i plotë i këtyre pikave gjendet në këtë artikull.
 52. “Kushtetutat”, (603).
 53. Konkili i II i Vatikanit, “Costituzione Dogmatica su la Chiesa” (Lumen Gentium), nn. 66-69. Shih shënimin 2.
 54. “Vizioni shpirtëror” i përmendur këtu përfshin përgjigjen e plotë të fesë paraqitur në seksionet e mëparshme të dokumentit. Edhe njëherë, gjithçka që i përket drejtësisë nuk mund të jetë e ndarë prej fesë e dashurisë ungjillore në të cilat gjen themelin.
 55. Shprehja është shkëputur nga meditari i ‘Mbretërisë së Krishtit’: “Ushtrime Shpirtërore”, § 97. Qëllimi i këtij ushtrimi është të çojë ushtruesin në një ndjekje më të ngushtë të Krishtit.
 56. Të shkëlqyerit për të cilën flas konsiston në këtë, që nxënësit tanë të jenë njerëz me parime të drejta e të asimiluara mirë, e të jenë në të njëjtën kohë burra e gra të hapur mbresave të kohës, në sintoni me kulturën e problemet e ambientit të tyre”. NCHM, § 9.
 57. Disa kritere për matjen korrekte të të shkëlqyerit gjinden në seksionin 9.1; kemi të bëjmë me të njëjtat kritere të vlefshme për vlerësimin.
 58. NCHM, § 6.
 59. “Shprehja e pazakontë që Atë Pedro Arrupe përdorte me dëshirë – pra që ne duhet ‘të formojmë shumëfishues’ – rridhte në realitet nga origjina e vizionit apostolik të Injacit. Korrespondenca e tij e 6815 letrave vë në dukje që Injaci nuk ka pushuar asnjëherë të kërkojë e nxisë bashkëpunim më të gjerë me lloj lloj personash ... (Atë Peter-

- Hans Kolvenbach, në sesionin e hapjes së Kongresit botëror të Ish-Nxënësve. Shih shënimin 24.).
60. NCHM, § 12.
61. “Kemi nevojë të mësojmë e kemi detyrimin të ndajmë. Avantazhet e ndërkëmbimeve e të bashkëpunimit të çdo lloji janë të pamasa. Do të ishte e kotë të pretendosh që nuk kemi asgjë për të mësuar. Do të ishte papërgjegjësi të bëjmë plane vetëm për llogari tonë pa marrë parasysh nevojat për t’u bashkuar me kolegje të tjera fetare, apo dhe laike ... Ky artikullim i punës tonë ... do të fuqizojë efektshmërinë tonë apostolike dhe ndërgjegjen tonë ekleziale”. (Ibid., § 25). Problemi i verifikimit rimerret më gjerësisht në seksionin 9.
62. Kjo shprehje e Injazit gjendet në një letër shkruar Juan de Verdolay më 24 korrik 1537. (“Monumenta Ignatiana”, Epp. XII, 321 e 323).
63. “Apostolicam Actuositatem” – “Dekreti mbi apostulatin e laikëve” – shih shënimin 2.
64. Kongregacioni i XXXI i Përgjithshëm, Dekreti 33 (“Qëndrimi i Shoqërisë ndaj laikëve e apostulati i tyre”); Dekreti 28 (“Apostulati i edukimit”) n.27. Kongregacioni i XXXII i Përgjithshëm, Dekreti 2 (“Jezuitët sot”) n.29. Kongregacioni i XXXIII, Dekreti 1 (“Miq të Jezusit dërguar në shoqërinë e sotme”) n.47.
65. “Ne ishim të mësuar të konsideronim universitetin si një institucion ‘tonin’ e të konsideronim laikët si ndihmësa edhe kur numri i tyre ishte dukshëm më tepër se i jezuitëve. Sot, sipas disa jezuitëve, numri i laikëve është rritur kaq shumë e detyrat administrative i kanë kaluar të tjerëve që, në realitet, arsimit nuk është më i jezuitëve ... Unë besoj që gjithë universiteti është e duhet të jetë një mjet apostulati: *Jo vetëm i jezuitëve, por jezuitësh e laikësh, që punojnë së bashku*”. (Atë Kolvenbach, ‘L’università dei Gesuiti oggi’, shih shënimin 39).
66. Shih më përpara në seksionin 8.7 e 9.3.
67. Kongregacioni i XXXI i Përgjithshëm, Dekreti 28, “Apostulati i edukimit”, n. 27).
68. Kongregacioni i XXXII i Përgjithshëm, Dekreti 2, “Jezuitët sot”, n. 29.
69. NCHM, §§ 16, 18.
70. “Do të jetë e vlefshme të shqyrtosh mundësinë nëse leverdis apo jo të krijosh në disa shkolla tona të mesme një këshill qeverisjeje, të përbërë nga tanët e të jashtëm”. (Kongregacioni i XXXII i Përgjithshëm, Dekreti 28, “Apostulati i edukimit”, n. 27).
71. “Duhet të vazhdojmë dakort (me prindërit) në edukimin. Meritojnë çdo lëndatë organizatat – shoqatat, revistat, konferencat – që nxisin formimin e prindërve të nxënësve në fushën edukative dhe i përgatitin të bashkëpunojnë më me efektshmëri me kolegjin”. (NCHM, § 22).
72. “Shoqëria nuk mund të mos interesohet për detyrën e saj që të merret me formimin e përhershëm të ish-nxënësve ... Është një vepër që praktikisht vetëm ne mund ta kryejmë, sepse duhet të rimodelojmë atë që kemi bërë njëzet apo tridhjetë vjet më parë. Njeriu i sotëm duhet të jetë i ndryshëm nga ai që kemi formuar një kohë. Është një detyrë e pafund, tej mundësiave tona, për të cilën duhet të shfrytëzojmë laikë të aftë në ndihmën për ta realizuar”. (Ibid., § 23).
73. “Cili është angazhimi i Shoqërisë së Jezusit drejt jush, ish nxënësve të saj? Është i njëjti angazhim i Shën Injazit, i rinovuar nga Atë Arrupe: të ju ndihmojë të bëheni shumëfishues, të ju ndihmojë për të integruar në jetën tuaj vizionin e Injazit e ... misionin e Shoqërisë ... Formimi që keni marrë duhet normalisht të ju ketë komunikuar kuptimin e vlerave e të angazhimit që karakterizojnë jetën tuaj si dhe aftësinë në një ndihmë reciproke në vazhdimin e këtij angazhimi e në zbatimin e këtyre vlerave e rrethanave që ndryshojnë në botë. Jezuitët nuk do t’u braktisin – por ata nuk kanë synim të vazhdojnë t’u drejtojnë. Ne do të jemi me ju për t’iu shoqëruar, frymëzuar, interpeluar e ndihmuar; por besojmë se ju vetë do të bëni që formimi që keni marrë të ketë frut në jetën tuaj e në shoqëri”. (Atë Kolvenbach Ish-Nxënësve në Versailles; shih shënimin 24. Gjithë fjalimi është mbi temën e marrëdhënieve në mes Shoqërisë së Jezusit e Ish-Nxënësve të saj).
74. Fjala “vlerësim” përdoret në kontekste të shumtë e të ndryshëm. Injaci ka shkruar disa “Rregulla për Vlerësimin e Shpirtave”; shih “Ushtrime Shpirtërore”, §§ 313-336. Në kontekstin tonë kemi të bëjmë më parë me atë “vlerësim apostolik të përbashkët” i praktikuar nga jezuitët e parë e i rekomanduar nga Kongregacioni i XXXIII i Përgjithshëm: një rishikim i punës apostolike, që përfshin “dëgjimin e Fjalës së Hyjit; shqyrtimin e vendimin sipas traditës injaciane; kthimin personal e të përbashkët, që kërkohet për t’u bërë me të vërtetë ‘soditës në veprim’; angazhimi për të jetuar në këtë ‘indiferencë’ e ‘gatishmëri’ të nevojshme për ‘të gjetur Hyjin në të gjitha gjërat’; transformimin e skemave tona të zakonshme të mendimit, në sajë të lidhjes reciproke konstante në mes eksperiencës, reflektimit e veprimit. Do të duhet më tej të zbatojmë vazhdimisht kriteret për veprimin tonë që “Kushtetutat” ofrojnë në Pjesën e VII, e treguesit konkretë të kohëve të fundit ...” (C.G .XXXIII, Dekreti 1, n. 40).
75. Një nga burimet e plotë më të fundit dhe të plotë është letra Shoqërisë mbi “Vlerësimin Apostolik të Përbashkët” shkruar nga Ati i Përgjithshëm Peter-Hans Kolvenbach, në nëntor 1986. Mbi këtë temë na jepet një minierë informacionesh, perspektivë historike e jepen këshilla për sot.
76. Shih “Kushtetutat”, Pjesa VII, në veçanti (622)-(624).

77. Vartësia e veprimtarive edukative të jezuitëve nga parimet e metodat e “Ushtrimeve Shpirtërore” ka qenë objekt i mjaft studimeve. Një ndër veprat klasike – pak e vjetruar, por gjithnjë me vlerë – që trajton gjerësisht këtë temë është ajo e François Charmot, S.I., “La pédagogie des Jésuites”, Paris, 1941. Konsiderata më të fundit gjinden në veprën e Robert R. Newton, “Riflessioni sui principi educativi degli Esercizi Spirituali” (Monografia n.1 publikuar në 1977 nga JSEA – shih shënimin 46 –) e në atë të Joseph Thomas, S.I., “Le Secret des Jésuites. Les exercices spirituels”. (Desclée de Brouwer, Paris, 1984).
78. Shih seksionin 1.
79. Injaci shkruan “Praesupponendum” e Ushtrimeve Shpirtërore për të treguar cili duhet të jetë raporti në mes ushtruesit e atij që jep Ushtrimet. Kjo “premisë” mund të jetë një ndihmë e madhe në çdo formë të marrëdhënieve njerëzore, veçanërisht në brendësi të një bashkësie edukative. Japim tani një përkthim letrar të tekstit në spanjisht të Injacist:
- “Me qëllim që cili jep Ushtrimet Shpirtërore ashtu dhe cili i merr të ndihmohen sa më mirë e të përfitojnë, është e nevojshme të presupozojmë që çdo i krishterë i mirë duhet të jetë më i gatshëm të japë një interpretim të mirë të pohimit të tjetrit se sa ta dënojë si falso. E nëse nuk ia del ta shpëtojë të kërkojë se çfarë kuptimi i jep ai që e propozon. E se në të do të kishte një kuptim të gabuar, ta korrigjojë me dashuri; e nëse kjo nuk mjafton akoma, të kërkojë të gjitha mjetet e përshtatshme për ta çuar në një interpretim të drejtë e kështu ta mbrojë nga gabimi pohimin e thënë”. (Esercizi Spirituali”, § 22).
80. NCHM, § 12.
81. “Fjalim i Atit të Përgjithshëm Peter-Hans Kolvenbach në Winnipeg, Kanada, më 14 maj 1986 në St. Paul’s High School”; publikuar në ‘Newsletter’ të Provincës së Kanadasë së Sipërme, qershor 1986, fq. 7-8.
82. Janë përkthime të ndryshme të origjinalit spanjisht të veprës që shpesh është quajtur “Autobiografia” e Shën Injacist.
83. “Autobiografia”, § 1.
84. Ibid., § 6.
85. Ibid., § 8.
86. Ibid., § 9.
87. Ibid., § 17.
88. Ibid., § 24.
89. Ibid., § 25.
90. Ibid., § 27.
91. “Ushtrime Shpirtërore”, § 230. (Shih shënimin 8).
92. “Autobiografia”, § 30.
93. Ibid., § 99.
94. Shih shënimin 8.
95. “Autobiografia”, § 50.
96. Shih shënimin 62.
97. “Autobiografia”, § 82.
98. Ibid., § 85.
99. Ibid., § 85.
100. Ibid., § 96.
101. “Formula”, n.1; (shih shënimin 33).
102. “Ushtrime Shpirtërore”, § 233.
103. Shih shënimin 7.
104. “Kushtetutat”, (307).
105. Ibid., (351).
106. Ibid., (366).
107. Ibid., (375) e (378).
108. Ibid., (381).
109. Ibid., (421)-(439).
110. Ibid., (395).
111. Ibid., (398).
112. Ibid., (395).
113. Ibid., (396). Kolegji Roman u krijua nga Injaci në 1551; edhe pse fillimet e tij qenë shumë modeste, ai duhej të bëhej model për shkollat e jezuitëve të gjithë botës. Me kalimin e kohës Kolegji Roman bëhet një universitet dhe emri i tij, i ndryshuar pas unifikimit kombëtar italian, është sot “Universiteti Papnor Gregorian”.
114. Originali latinisht i “Ratio Studiorum” të 1599, së bashku me skemat përgatitore, është publikuar kohët e fundit në vol. V të “Monumenta Paedagogica Societatis Jesu”, a cura di Ladislaus Likacs, S.I. (Institutum Historicum Societatis Jesu, Roma, Italia, 1986).
115. Prej Dekretit Papnor “Sollicitudo Omnium Ecclesiarum” të 7 gushtit 1814 me të cilën Shoqëria e Jezusit ishte ristabilizuar në gjithë botën.
116. Shtesa I (175); këto emra, që Injaci i përdor për të folur për Hyjin, gjinden në të gjithë shkrimet e tij; shih psh., “Ushtrime Shpirtërore”, §§ 15, 16.
117. Ky është “Parim e Bazë” e “Ushtrime Shpirtërore”, § 23; shih shënimin 8.
118. Mendimi i Hyjit që punon për ne nëpërmjet krijimit është qendror në përshtatshmitë injaciane. Dy shembuj që gjinden në “Ushtrime” janë soditja mbi ‘Mishërimin’, §§ 101-109, e ‘Soditje për të mbajtur dashurinë’, §§ 230-237. Citimi është nga § 236. Injaci fliste shpesh për “të shikosh Hyjin në të gjitha gjërat”; kjo shprehje që parafrazuar nga Nadal (një nga shokët e gjeneratës së parë) në të njohurin “soditës në veprues”.

119. Shtesa I (173).
120. Qëllimi që ka ai që don të bëjë “Ushtrime Shpirtërore” është sintetizuar në shprehjen ‘Liri Shpirtërore’. Vetë Injaci i ka dhënë librit të tij titullin: “Ushtrime Shpirtërore për të fituar mbi vetveten e për të vënë rregull në jetën tonë pa marrë kurrë vendime në bazë të ndonjë prirjeje, që është jo e rregullt”. (§ 21).
121. Shtesa I (172); kjo shprehje përbën një përmbledhje të “Javës së Parë” të “Ushtrimeve”.
122. Shtesa I (173); “Ushtrimet”, §§ 313-329 (‘Rregulla për Vështrimin e Shpirtave’).
123. Shtesa I (173); “Ushtrimet”, §§ 142-146 (‘Dy Flamujt’).
124. “Ushtrimet”, §§ 24-43 (disa mënyra për të bërë një shqyrtim ndërgegjeje), e ‘Dy Flamujt’, të cituara sipër.
125. Shtesa I (173), (182): “Ushtrimet”, § 53, §§ 95-98 (‘Krishti, Zoti ynë, mbret në përjetësi’); § 167 (‘Shkalla e tretë e Përvujtërisë’). E dyta, treta dhe e katërta ‘javë’ e Ushtrimeve kanë synim të çojnë ushtruesin të angazhohet në ndjekjen e Krishtit.
126. “Ushtrime”, § 116 (‘Pika e tretë’ e ‘Soditjes mbi Lindjen’); dhe sipas ‘Dy Flamujve’, cituar më sipër.
127. Shtesa I (173), (179), “Ushtrime”, § 135, §§ 169-189 (‘Zgjedhja’).
128. Shtesa I (177), (184).
129. “Ushtrime”, §§ 352-370 (‘Rregulla për t’u ndjerë pranë Kishës’); “Formula”, n. 3; “Kushtetutat”, (603), e passim në shkrimet e Injacit. Kur ai kuptoi se nuk ishte e mundur të shkonte në Tokën e Shenjtë për t’i shërbyer drejtpërdrejtë Krishtit, Injaci zgjodhi si “gjënë e dytë më të mirë” të shkojë në Romë për t’u vënë në shërbim të Kishës nën “Vikarin e Krishtit”.
130. Devocioni ndaj Marisë, nënës së Jezusit, është i dukshëm në gjithë jetën e Injacit; siç është përshkruar në Shtesën I (171), pelegrinazhi i Injacit filloi nga Montserrat; “Zoja Jonë” duket në gjithë librin e “Ushtrimeve”, psh. në §§ 47, 63, 102ss, 11s, 147, 218, 299.
131. Shtesa I (180), (182). Sipas disa autorëve që Injaci që futi shprehjen ‘Vikar i Krishtit’; që kjo të jetë e vërtetë apo jo, devotshmëria e sinqertë ndaj Papës është karakteristike si e Injacit ashtu dhe e Shoqërisë së Jezusit nga ai e themeluar.
132. Shtesa I (173); “Ushtrime”, §§ 97, 155.
133. Shtesa I (178), (181).
134. “Vlerësimi i shpirtave” karakterizon gjithë jetën e Injacit; ajo është tashmë e dukshme në Manresa (Shtesa I, 170), por rritet në mënyrë konstante gjatë jetës së tij. Një dokument i shkurtër i titulluar “Vendimet e Etërve të Parë” përshkruan vështrimin nëpërmjet të cilit Injaci dhe shokët e parë arritën në formimin e Shoqërisë së Jezusit. Shih dhe Shënimin I (189)-(193) për procesin që çon në të parin “Ratio Studiorum”, e shih “Ushtrime”, §§ 313-336 (‘Rregulla për Vlerësimin e Shpirtave’).

Treguesi:

Hyrje

faqe:

3

Karakteristikat e veprimtarisë edukative të Shoqërisë së Jezusit	
Shënime hyrëse	10
1.1. Pohon që bota është pozitive në themel të saj	14
1.2. Formimi integral i çdo personi brenda bashkësisë	15
1.3. Aspekti fetar përshkon të gjithë veprimtarinë edukative	18
1.4. Një mjet apostolik	20
1.5. Dialogu midis fesë dhe kulturës	20
2.1. Kujdes i veçantë për çdo njeri	22
2.2. Roli aktiv i studentëve në procesin e përvetësimit të mësimave	24
2.3. Dëshirë konstante formimi	25
3.1. Edukim në vlerat	27
3.2. Realizëm i shëndoshë në njohje, dashuri dhe pranim i vetvetes	28
3.3. Një njohje realiste e botës	30
4.1. Krishti është modeli	31
4.2. Kujdes baritor	32
4.3. Lutja vetjake dhe celebrimi i fesë	33
5.1. Angazhim aktiv në jetë	35
5.2. Edukim i një diakonie fetare që nxit drejtësinë	36
5.3. Burra dhe gra për të tjerët	39
5.4. Vëmendje të veçantë për të varfërit	40
6.1. Një mjet apostolik në shërbim të kishës	44
6.2. Përgatit për një pjesëmarrje aktive brenda kishës	46
7.1. Të shkëlqyerit i ndjekur në formim	48
7.2. Të japësh dëshmi të të shkëlqyerit	51
8.1. Bashkëpunim midis laikëve dhe jezuitëve	52
8.2. Mësuesit dhe drejtuesit	54
8.3. Bashkësia e jezuitëve	54
8.4. Këshillat e shkollës	55
8.5. Prindërit	55
8.6. Studentët	57
8.7. Ish-nxënësit	58
8.8. Bamirësit	58
8.9. Strukturat e shkollës	59
	faqe:
9.1. Rishikim dhe modifikim për të arritur pikësynimet e edukimit	63

9.2. “Sistemi” i shkollave të jezuitëve	64
9.3. Trajnim profesional dhe formim i vazhdueshëm	65
10. Disa karakteristika të pedagogjisë së jezuitëve	67
A. Nga përvoja e “Ushtrimeve Shpirtërore”	67
B. Disa shembuj direktivash të nxjerra nga “Kushtetutat dhe nga “Ratio Studiorum”	69
Përfundimi	71
Shtesa I: Injaci, shkollat e para të jezuitëve dhe “Ratio Studiorum”	
A. Itinerari shpirtëror i Injacidit të Loyolës	73
B. Shoqëria e Jezusit angazhohet në veprimtarinë edukative	81
C. “Ratio Studiorum” dhe historia e kohëve të fundit	85
Shtesa II: Vizioni i botës së Injacidit në raport me Karakteristikat themelore të edukimit të jezuitëve	90
Shënime	98
Treguesi	109